Asociation "Loyola-Gymnasium"

Jahrbuch
Vjetari

# 2021/22

Loyola Campus

## Shkolla Fillore
## Gymnasium
## Konvikt
## Loyola-Profesionale

# Kontakt - Kontakti

**Direktor - Drejtor**
Elias Koller
elias.koller@alg-prizren.com

**Schulleiter Gymnasium - Drejtor i Loyola-Gymnasium**
Prof. Enver Sulaj
enver.sulaj@alg-prizren.com

**Sellvertetende Schulleiterin Gymnasium - Zëvendësdrejtoreshë e Loyola-Gymnasium**
Prof. Shqipe Sharani
shqipe.sharani@alg-prizren.com

**Internatsleitung - Drejtor i konviktit**
Arianit Çollaku
arianit.collaku@alg-prizren.com

**Schulleitung Grundschule - Drejtoresha e shkollës fillore**
Sr. Lindita Spaqi MSc
lindita.spaqi@alg-prizren.com

**Projektleiter Loyola Profesionale - Drejtor i Loyola-Profesionale**
Visar Hoxha
visar.hoxha@alg-prizren.com

**Leiterin Finanzen/Administration - Drejtoreshë e financave/administratës**
Hamide Elshani
hamide.elshani@alg-prizren.com

**Anschrift/Kosovo**
Asociation "Loyola-Gymnasium"
Rr. e Tranzitit - Petrovë
20000 Prizren - Republik Kosovo
Telefon: +377 44 4340 87
Telefon: +377 44 8279 09
E-Mail: alg-info@alg-prizren.com

**Redaktion**
Elias Koller, Enver Sulaj

**Layout und Design**
Horst Blassl

**Druck**
GOTTESWINTER UND FIBO DRUCK-
UND VERLAGS GMBH, München







Staatlich anerkanntes, klassisches, privates Gymnasium mit einem Internat für Jungen und einem Internat für Mädchen, in Prizren im Kosovo.

Gjimnaz klasik, privat, i pranuar nga shteti me një konvikt për vajza dhe një konvikt për djem në Prizren, në Kosovë.

Liebe Leser,

unser Jahrbuch soll Sie über uns und das, was wir in den letzten Jahren und im letzten Schuljahr alles erreicht haben, informieren.

Wenn Sie dieses Jahrbuch durchblättern, werden Sie sehr schnell feststellen, dass wir nicht alle deutschen Texte ins Albanische übersetzt haben und umgekehrt. Dennoch wagen wir, es Ihnen in dieser Form vorzulegen. Überall, wo der Text nicht weiterhilft, sprechen die Bilder "unserer" Kinder für sich.

Wir sind angetreten, um für die Zukunftschancen der Kinder des Kosovo etwas zu tun. Sie sind es wert, dass wir uns für sie einsetzen. Unsere Schulen sind einerseits nur ein kleiner Beitrag, andererseits ein deutlich sichtbares Zeichen der Hoffnung.

Für Ihre Unterstützung und Ihr Interesse sei Ihnen allen ganz herzlich gedankt!

Ihr
ALG-Team

Redaktionsschluss: 31.12.2022

Të dashur lexues,

"Vjetari" ynë do t'ju njohë me ne, do t'ju informojë për arritjet tona në këto vite, dhe në veçanti, në vitin e fundit shkollor.

Kur ta shfletoni këtë Vjetar, do të kuptoni shumë shpejt se ne nuk i kemi përkthyer të gjitha tekstet e gjuhës gjermane në shqip. Prapëseprapë ne po ju drejtohemi në këtë mënyrë. Gjithkund ku nuk ju ndihmon teksti, për ju flasin fotografitë e fëmijëve tanë.

Ne e ndërmorëm këtë, sepse duam të bëjmë diçka, t'u japim një shans për ardhmërinë fëmijëve të Kosovës. Ata e meritojnë këtë. Shkolla jonë me konvikte është vetëm një kontribut i vogël, dhe në anën tjetër, një shkëndijë shpresëdhënëse për të ardhmen.

Ju falënderojmë dhe ju jemi shumë mirënjohës për interesimin dhe përkrahjen tuaj!

Juaji
ekipi i ALG-së

Redaktimi u përfundua më 31.12.2022

Liebe Leserinnen und Leser unseres Jahrbuchs, liebe Freunde und Förderinnen und Förderer der Asociation "Loyola-Gymnasium",



Nach drei Jahren künstlerischer Pause kommen wir alle nun endlich wieder in den Genuss, das traditionelle Jahrbuch der Asociation "Loyola-Gymnasium" (ALG) in den Händen zu halten. Im Vergleich zu den unzähligen Stunden Arbeit von allen Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern im letzten Jahr, sind die folgenden Berichte im Jahrbuch nur ein sehr kleines aber wichtiges Abbild dessen, was tagtäglich an der ALG geleistet wird. Es ist mir deshalb ein großes Anliegen, gleich mit einem von Herzen kommenden Dankeschön zu beginnen. Dieser Dank geht an alle Mitarbeiterinnen und Mitarbeiter der ALG, die durch ihren unermüdlichen Einsatz wesentlich zum Erfolg dieses Leuchtturmprojekts im Balkan beitragen. Ganz herzlich möchte ich mich auch bei allen Eltern unserer Schülerinnen und Schüler bedanken, die durch ihr Vertrauen in unsere Arbeit auch einen wesentlichen Beitrag zur Entwicklung und dem Weiterbestehen der ALG leisten. Ohne die Trägerschaft (Trägerverein) der ALG und dessen Vorstand sowie unsere nationalen und internationalen Partner aus Wirtschaft, Politik, kirchlichen Kreisen und Zivilgesellschaft wären wir nicht so erfolgreich. Auch Ihnen möchte ich an dieser Stelle ganz herzlich für die Unterstützung und den Glauben an unsere Mission danken. Ich erlaube mir zu behaupten, dass die Asociation "Loyola-Gymnasium" mit ihrer Grundschule "Loyola-Fillore", ihrem "Loyola-Gymnasium", ihrem Internat "Loyola-Konvikt" und ihrem Berufsbildungszentrum "Loyola-Profesionale" über die Grenzen des Kosovo hinaus weiterhin zu den besten Schulen im Balkan gehört. Lassen Sie sich selbst von den folgenden Beiträgen und Bildern davon überzeugen, dass an der ALG weit mehr als "klassischer Unterricht" geleistet wird.

Ich habe lange gezögert, mich aber dennoch entschieden in diesem Jahrbuch auf die Covid-19 Pandemie und deren Auswirkungen auf unserer Arbeit in den letzten knapp drei Jahren einzugehen. Die Covid-19 Pandemie hat weltweit nie dagewesene Herausforderungen in wirtschaftlicher, sozialer und politischer Hinsicht geschaffen. Sie ist nicht nur eine Gesundheitskrise, sondern hat auch zu einer Bildungskrise geführt. Während der Schließungen und Quarantänen waren 87 % der weltweiten Schülerbevölkerung betroffen, und 1,52 Milliarden Lernende waren nicht in der Schule oder ähnlichen Bildungseinrichtungen (UNESCO Learning Portal, 2020). Die Plötzlichkeit, Ungewissheit und Volatilität des Corona Virus führte dazu, dass sich das Bildungssystem im Kosovo, aber auch unser Bildungssystem an der ALG mit der veränderten Lernlandschaft auseinandersetzen mussten.

Die durch Covid-19 verursachte "Störung" des Bildungs- und Lernsystems war von großem Ausmaß, mit dem auch wir an der ALG so schnell wie möglich fertig werden mussten. Alle Beteiligten wurden aufgerufen, ein widerstandsfähiges Lernsystem zu entwickeln, damit reaktionsfähige und proaktive Maßnahmen eingeleitet werden konnten. Die Bewältigung der Auswirkungen von Covid-19 an der ALG erforderte eine Vielzahl von Perspektiven unter den Beteiligten und insbesondere unter den Leitungspersonen. Die Schulleitung, die die Lehr- und Lernprozesse unterstützt, die Schülerinnen und Schüler, die den Kern des Systems bilden, die Lehrkräfte, die verschiedene pädagogische Aufgaben wahrnehmen, die Eltern und Erziehungsberechtigten, die für die Kontinuität des Lernens mitverantwortlich sind, die Gemeinschaft und die externen Partnerinnen und Partner, die zur Erfüllung der Bildungsanforderungen der Schülerinnen und Schüler beitragen. Sie alle mussten in die Beratungen einbezogen werden. Diese Situation hat einmal mehr die Komplexität der ALG aufgezeigt und klargemacht, dass die ALG eine große Anzahl von Interessengruppen hat.

Der Lehr- und Lernprozess nimmt in Krisenzeiten eine andere Form an. Auch an der ALG mussten wir unsere Widerstandsfähigkeit ausbauen und neue Wege finden, um die Lehr- und Lernaktivitäten fortzusetzen. Eine neue Realität, die sich infolge der weltweiten Gesundheitskrise abzeichnete, war die Umstellung auf Online-Lernformen, um das Risiko der persönlichen Interaktion zu mindern. Wir waren in den Bildungseinrichtungen der ALG aufgrund der Pandemie gezwungen, von der Präsenzlehre auf Online-Unterricht (und später Hybrid-Unterricht) umzusteigen.

Diese plötzliche Umstellung hat zu kleineren Problemen geführt, insbesondere für Lernende, die keinen Zugang zu Technologie hatten. Wenn aufgrund der Pandemie Online-Lernmethoden eingesetzt werden, vergrößert sich die Kluft zwischen denjenigen, die über einen Internetzugang verfügen, und denjenigen, die keinen haben. Die Aufrechterhaltung des pädagogischen und akademischen Engagements war für Lehrkräfte und Schülerinnen und Schüler aufgrund des Zugangs und der Internetanbindung teilweise eine Herausforderung.

Insgesamt konnten wir an der ALG dennoch mit vereinten Kräften dafür sorgen, dass der Unterricht auch während der Pandemiejahre erfolgreich stattfinden konnte. Es ist uns zwar gelungen, interne Prozesse anzupassen, aber die "Abhängigkeit" vom trägen Bildungssystem und damit dem vorgeschriebenen Kurrikulum des kosovarischen Bildungssystems war deutlich spürbar.

Ich hoffe, dass das Bildungsministerium, basierend auf den in dieser Zeit gesammelten Informationen und Daten, gemeinsam mit den Schulen die Bereiche Lehrplan und Unterricht, Engagement der Schülerinnen und Schüler sowie Technologie und Infrastruktur kritisch analysiert, um so Stärken und Schwächen identifizieren zu können.

Um die Kontinuität des Lehrens und Lernens während und nach der Pandemie zu gewährleisten, müssen die Schulen zu flexiblen Lehr- und Lernformen übergehen, indem sie den Lehrplan neu abstimmen, die Lehrkräfte aus- und weiterbilden und die Infrastruktur aufrüsten. Diese strategischen Maßnahmen müssen kontinuierlich bewertet, geändert und verbessert werden, um auf die unbeständigen, unsicheren und sich verändernden Szenarien in Krisenzeiten zu reagieren.

Wir brauchen zudem Zusammenarbeit, Einfühlungsvermögen und Teamwork, um die Bildung zu verändern. Junge Menschen spielen eine wichtige Rolle bei der Schaffung eines flexiblen, nachhaltigen und lebensbegleitenden Bildungssystems, das den Bedürfnissen der Zukunft gerecht wird. Der Erfolg jeder Gesellschaft hängt von ihrer Fähigkeit ab, eine gebildete Bevölkerung auf Dauer zu erhalten. Deshalb brauchen wir den Kontakt und die Erfahrung junger Menschen, um das Bildungssystem so zu gestalten, dass es den Anforderungen von heute und morgen gerecht wird.

Auch im Schuljahr 2021/22 konnten sich unsere Semi-Maturantinnen und Semi-Maturanten und Maturantinnen und Maturanten durch exzellente Durchschnittsnoten auszeichnen. Alle teilnehmenden Schülerinnen und Schüler der ALG an den zentralen Maturaprüfungen haben diese bestanden.

Der Campus der ALG ist mehr als eine Schule. Es ist eine Begegnungsstätte von Menschen die an den Auftrag und die Wichtigkeit von Bildung von jungen Menschen glauben.

Es erstaunt deshalb nicht, dass auch im vergangenen Schuljahr und insbesondere in den Sommermonaten sehr viele Organisationen aus dem Bildungssektor, aber auch darüber hinaus, den Kontakt zur ALG gesucht haben, um hier in Prizren gemeinsame Projekte durchzuführen, Initiativen zu lancieren und durch geschaffene Synergien einen eminent wichtigen Beitrag zur Förderung von Kindern und Jugendlichen in der Region zu leisten.

Abschließend können wir alle sehr stolz auf das letzte Schuljahr zurückblicken und erkennen, dass die ALG auch in stürmischen Zeiten auf eine starke Verankerung zurückgreifen kann. Diese Verankerung schafft Vertrauen, signalisiert aber auch den Auftrag, agil und innovativ zu bleiben. Die Anwendung von alters- und formgerechter Pädagogik und die Stärkung einer resilienten und selbstreflektierenden jungen Gesellschaft ist und bleibt unser Auftrag an der ALG. Wir sind bereit, diesen Auftrag auszuführen und weiterzuentwickeln und rufen Sie, liebe Leserinnen und Leser dazu auf, uns dabei tatkräftig zu unterstützen. Mit Ihrer Hilfe kann die ALG noch viele Jahre als Leuchtturm ihr Licht an die jungen Menschen weitergeben.

In diesem Sinne wünsche ich Ihnen ein gutes und friedliches neues Schuljahr 2022/23!

Të dashur lexuese dhe lexues të Vjetarit tonë, të dashur miq dhe përkrahës të Asociationit "Loyola-Gymnasium",



pas tre vjetësh pauzë artistike, tani, më në fund, të gjithë kemi kënaqësinë që ta shfletojmë sërish Vjetarin tradicional të Asociation "Loyola-Gymnasium" (ALG). Në krahasim me orët e panumërta të punës dhe angazhimit të punonjëseve dhe punonjësve tanë vitin e kaluar, raportet vijuese paraqesin vetëm një pasqyrë të vogël, por të rëndësishme të asaj, se çfarë realizohet dhe arrihet çdo ditë në ALG. Për këtë arsye, për mua është shumë e rëndësishme që t'ia filloj me një falënderim që vjen nga zemra. Ky falënderim u drejtohet të gjithë punonjëseve dhe punonjësve të ALG-së, të cilët me punën e tyre të palodhshme kontribuojnë në mënyrë thelbësore në suksesin e këtij projekti madhështor prijatar në Ballkan. Përzemërsisht dua t'i falënderoj edhe prindërit e nxënëseve dhe nxënësve tanë, të cilët përmes besimit të tyre në punën tonë japin një kontribut domethënës në zhvillimin dhe kontinuitetin e ALG-së. Pa Shoqërinë bartëse të ALG-së dhe kryesinë e saj, si dhe pa partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë nga fusha e ekonomisë, politikës, qarqeve kishtare dhe shoqërisë civile, nuk do të mund të ishim kaq të suksesshëm. Edhe ata dua t'i falënderoj përzemërsisht për përkrahjen dhe besimin e treguar në misionin tonë. Marr lirinë që të pohoj se Asociation "Loyola-Gymnasium" bashkë me shkollën fillore "Loyola-Fillore", gjimnazin "Loyola-Gymnasium", konviktin "Loyola-Konvikt" dhe me qendrën për aftësimin profesional "Loyola-Profesionale" edhe përtej kufijve të Kosovës i përket shkollave më të mira në Ballkan. Ju do të bindeni edhe vetë nga artikujt dhe fotot në vijim se në ALG zhvillohet shumë më shumë se sa një "mësim klasik".

Për një kohë të gjatë ngurrova, mirëpo megjithatë vendosa që në këtë Vjetar ta prek temën e pandemisë me COVID-19 dhe ndikimet e saj në punën tonë në këto tre vjetët e fundit. Pandemia COVID-19 ka krijuar sfida në aspektin ekonomik, shoqëror dhe politik, të cilat nuk kanë ekzistuar kurrë më parë askund në botë. Ajo nuk ka qenë vetëm një krizë shëndetësore, por ka shpënë edhe në një krizë në sistemin arsimor. Nga mbyllja dhe karantinimi ka qenë e prekur diku rreth 87% e nxënëseve dhe nxënësve në mbarë botën dhe 1,52 miliardë nxënës nuk kanë pasur qasje në objekte shkollore apo institucione të ngjajshme arsimore (UNESCO, Learning Portal, 2020). Për shkak të paraqitjes së befasishme, pasigurisë, paqartësisë dhe paqëndrueshmërisë së situatës me koronavirus sistemi arsimor në Kosovë dhe me këtë edhe sistemi ynë arsimor në ALG u përball me një situatë të ndryshuar të mbajtjes së mësimit.

"Pengesa" në sistemin e arsimit dhe në mbajtjen e mësimit, e shkaktuar nga COVID-19, ishte e përmasave të mëdha, të cilën edhe ne në ALG është dashur ta menaxhonim sa më shpejt që të ishte e mundur. Të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan që të zhvillojnë një sistem mësimor rezistent, në mënyrë që të mund të merreshin masat e nevojshme proaktive. Menaxhimi i ndikimeve të COVID-19 në ALG kërkonte një shumëllojshmëri perspektivash nga të gjithë pjesëmarrësit, e veçanërisht nga udhëheqësia. Drejtoria e shkollës, e cila i përkrahë proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies, nxënëset dhe nxënësit, të cilët paraqesin thelbin e sistemit, mësimdhënësit, të cilët kryejnë detyra të ndryshme pedagogjike, prindërit dhe kujdestarët ligjorë, të cilët janë bashkëpërgjegjës për kontinuitetin e të mësuarit, komuniteti dhe parneret e partnerët e jashtëm, të cilët kontribuojnë në përmbushjen e kërkesave arsimore të nxënëseve dhe nxënësve, është dashur të përfshiheshin në proceset e këshillimit. Kjo situatë edhe një herë më shumë ka vënë në pah kompleksitetin e ALG-së dhe na ka bërë të qartë që ALG ka një numër të madh grupesh interesi.

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies në kohë krizash merr një formë tjetër. Edhe ne në ALG është dashur që ta zhvillonim më tej rezistencën tonë dhe të gjenim mënyra të reja për të vazhduar aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Një realitet i ri, i cili u shfaq si pasojë e krizës globale shëndetësore, ishte kalimi në modalitetet mësimore online, për ta zvogëluar rrezikun që mund të shfaqej nga interaksioni personal. Për shkak të pandemisë, ne në institucionet arsimore të ALG-së ishim të detyruar që të kalojmë nga mësimi në prezencë tek modalitetet online (dhe më vonë modalitetet hibride).

Ky konvertim i papritur ka shpënë në probleme të vogla, veçanërisht për nxënësit, të cilët nuk kishin qasje në teknologji. Në rastet, kur për shkak të pandemisë përdoren metoda mësimore online, zmadhohet hendeku në mes atyre që kanë qasje në internet dhe atyre që nuk kanë. Mbajtja e angazhimit pedagogjik dhe akademik në nivel të duhur, për mësimdhënësit dhe nxënësit pjesërisht paraqiste një sfidë për shkak të qasjes në internet.

Megjithatë ne në ALG, me forcat tona të bashkuara në përgjithësi ia arritëm që t'i krijonim kushtet e nevojshme, në mënyrë që mësimi të mund të mbahej edhe gjatë kohës së pandemisë. Ne vërtet ia dolëm që t'i përshtatim proceset interne, mirëpo "varësia" nga sistemi i ngadaltë arsimor dhe me këtë edhe nga kurrikula e kërkuar nga Ministria e Arsimit të Kosovës ndjehej dukshëm. Ministria e Arsimit me ndihmën e shkollave në vend, pra në bazë të të dhënave të fituara, duhej të kryente analiza strategjike për skenarët më të mirë, të mundshëm apo të këqinj në fushën e planit mësimor dhe mësimit, angazhimit të nxënëseve dhe nxënësve, si dhe teknologjisë dhe infrastrukturës. Për ta siguruar kontinuitetin e mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë dhe pas pandemisë, shkollat duhej të kalonin në modalitetet fleksibile të mësimit, duke ripërpiluar planin mësimor, duke trajnuar mësimdhënësit dhe duke përmirësuar infrastrukturën. Këto masa strategjike duhej të vlerësoheshin, ndryshoheshin dhe përmirësoheshin në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të mund të reagohej drejt në rast të paraqitjes së skenarëve të paqëndrueshëm, të pasigurtë dhe të ndryshueshëm në kohë krizash.

Përveç kësaj ne na nevojitet bashkëpunimi, ndjeshmëria dhe puna ekipore për ta ndryshuar arsimin. Të rinjtë luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e një sistemi fleksibil, të qëndrueshëm dhe të përhershëm arsimor, i cili do të mund t'i përmbushë kërkesat e së ardhmes. Suksesi i secilës shoqëri varet prej vetë aftësisë së saj për të fituar dhe mbajtur një popullatë të arsimuar në planin afatgjatë. Për këtë arsye ne kemi nevojë për kontaktin dhe përvojën e njerëzve të rinj, në mënyrë që të mund të modelohet një sistem i atillë arsimor, i cili do të mund t'i përmbushte kërkesat e të sotmes dhe të nesërmes.

Edhe në vitin shkollor 2021-2022 semimaturantët dhe maturantët tanë ia dolën që të dallohen me notat e tyre shumë të larta mesatare. Të gjithë nxënësit pjesëmarrës të ALG-së e kanë dhënë me sukses Testin e Arritshmërisë dhe Provimin e Maturës Shtetërore.

Kampusi i ALG-së është më shumë se vetëm një shkollë. Është një vendtakim i njerëzve, të cilët besojnë në misionin dhe rëndësinë e arsimimit të njerëzve të rinj.

Nuk është befasues fakti se gjatë vitit të kaluar shkollor, e veçanërisht gjatë muajve të verës, shumë organizata nga sektori i arsimit, por edhe jashtë tij, kanë kontaktuar ALG-në për të realizuar këtu, në Prizren, projekte të përbashkëta, për të lansuar iniciativa dhe për të dhënë një kontribut jashtëzakonisht të rëndësishëm për fëmijët dhe të rinjtë në regjion, përmes sinergjive të krijuara.

Për fund mund të them se, ne të gjithë, me shumë krenari mund ta vështrojmë prapa vitin shkollor që e lamë pas dhe mund të shohim se ALG edhe në kohërat më të stuhishme mund të mbahet tek një spirancë e fortë. Kjo spirancë krijon besim, mirëpo sinjalizon edhe detyrën për të mbetur të shkathët dhe inovativ. Implementimi i një pedagogjie të përshtatshme në moshë dhe formë si dhe forcimi i një shoqërie të re të qëndrueshme dhe vetëreflektuese është dhe mbetet misioni ynë në ALG. Ne të gjithë jemi të gatshëm për ta zbatuar dhe për ta zhvilluar më tutje atë dhe Ju ftojmë Juve, të dashur lexuese dhe lexues, që të na përkrahni fuqishëm në këtë drejtim. Me ndihmën tuaj ALG mund të vazhdojë ta ndriçojë rrugën e dijes së njerëzve të rinj edhe për shumë vite të tjera.

Gëzuar Krishtlindjet dhe mbarësi e paqe në Vitin e Ri 2023!

Elias Koller,
drejtor ekzekutiv i Asociation "Loyola-Gymnasium"

## WIE SOLLTEN WIR VONEINANDER (NICHT) WEGRENNEN?



Die letzten Jahre waren für alle und auch für uns als Verein "Loyola-Gymnasium" besonders und schwierig. Aber nicht in jeder Erzählung sollte die Corona-Pandemie als Subjekt im Satz stehen. Vielmehr sollten auch unsere veränderten Prozesse und neu entstandenen Phänomene, die unsere Arbeit in dieser Zeit begleitet haben, Erwähnung finden.

"Wir haben uns alle verändert" ist der Satz, den man am häufigsten hört. Und sofort haben wir einen Bezugspunkt, wenn es um die Gründe für diese "Veränderung" geht. Was hat sich denn verändert? Diese Frage ist schwer zu beantworten. Aber in einigen Punkten sind wir uns alle einig. Die Menschen sind in Bewegung. Von einem Land zum anderen, von einer Region zur anderen, von einem Kontinent zum anderen. Was treibt diese Bewegungen an? Ist es die Suche nach einem besseren Leben, ist es der Mangel an Raum, um unsere Träume zu verwirklichen, oder ist es eine Leere, die wir alle spüren und persönlich erleben? Jeder bewegt sich in irgendeine Richtung und gleichzeitig laufen wir vor etwas davon.

Die Welt verändert sich. In einem neuen Kontext der Multipolarität versuchen Staaten wie Menschen, ihren Raum für ihre lang- und kurzfristigen geostrategischen Interessen (wieder) zu finden oder (neu) zu gestalten. Wenn die demokratischen Mittel ausgeschöpft sind, kommt die nächste Stufe - der Krieg. Voll von menschlichem Drama, Leid, Mord und Tragödie. Der Krieg in der Ukraine zeigt uns, dass die menschliche Grausamkeit periodisch recycelt wird, während die Liebe zur Freiheit das existenzielle Minimum jedes normalen Lebewesens bleibt. Jeder Anfang hat ein Ende, um mit etwas Neuem zu beginnen. Im gesellschaftlichen Wandel und in der globalen Entwicklung bleibt auch die Schule als Institution von zentraler Bedeutung nicht unberührt. Und das Problem aller Probleme bleibt einmal mehr Erziehung und Bildung. Bei all diesen Entwicklungen und Veränderungen, auch Transformationen genannt, hat das Schulsystem eine etwas größere Last zu tragen als sonst.

Das dynamische Leben der Eltern hat die Zeit, die sie mit ihren Kindern verbringen sollten, verkürzt. Zusätzlich zu den Mauern, die wir hochgezogen haben, hat die digitale Welt neue Barrieren geschaffen - in der menschlichen Kommunikation. Vieles ist virtuell geworden, von der Freundschaft über die Arbeit bis hin zum Leben. Kann die Schule allein all diese Lücken schließen? Mit Sicherheit nicht! Die Schule kann die Familie nicht ersetzen. Die Schule kann nicht die Lücke der menschlichen Nähe füllen, die durch die soziale Distanzierung entstanden ist. Diese soziale Distanzierung spiegelt sich im Verhalten der Kinder in der Schule wider - das Ergebnis sind Intoleranz, das Superego und eine Persönlichkeit, die ständig in Bewegung und auf der Suche nach etwas Unbekanntem ist. Veränderungen und Wandlungen in einer Gesellschaft lassen sich am leichtesten am Verhalten der Kinder ablesen. Unabhängig vom Bildungsstand der Eltern haben alle die gleiche Sorge: Wie sollen wir unsere Kinder erziehen? Welche Ansprüche sollen wir an sie stellen? Welches Verhalten ist akzeptabel und welches nicht?

Niemand sollte angesichts dieser Fragen gleichgültig bleiben: weder die Familie noch andere Institutionen und schon gar nicht die Schule. Die SchülerInnen lesen heutzutage weniger von der obligatorischen Schullektüre, aber sie lesen viel mehr Artikel und Onlinebeiträge nach eigenem Wunsch. Die SchülerInnen lassen heutzutage viel mehr Bilder aus dem Internet und der virtuellen Welt in ihr Gedächtnis eindringen als aus der Natur und ihrer realen Umgebung. Die SchülerInnen werden heute von allen Seiten mit Inhalten bombardiert, die sogar bei Erwachsenen für Verwirrung sorgen. Und wieder sind wir bei den Werten! Was sind heute Werte? Das Materielle oder das Spirituelle? Welche Lebensmodelle sind es, die unseren SchülerInnen heute durch die Medien, die sozialen Netzwerke usw. serviert werden? Wo ist die Grenze, an der wir innehalten und sagen müssen: "Es reicht!" Aus einem einfachen Grund: Grenzen helfen uns zu erkennen, dass das Universum unendlich ist und dass wir an einem Punkt innehalten und mit dem zufrieden sein sollten, was wir haben und was wir sind!

Vor dem Schulhof sieht man zu jeder Tageszeit Eltern, die

ihre Kinder zur Schule bringen oder nach dem Unterricht abholen. Mit viel Engagement und Liebe. Und wenn man sie fragt, erfährt man, dass alle irgendwie besorgt sind. Was sie an ihren Kindern sehen, ist nicht das Richtige. Und sie machen weiter, ohne zu wissen, ob es das Beste für sie ist. Was ist das Beste, fragt sich sicher jeder von uns.

Kinder müssen mit Liebe und Leidenschaft für ihre Mitmenschen erzogen werden. Wir sollten ihnen nicht sagen, wie sie reich werden können, sondern wie sie arbeiten müssen, um ihre Ideen zu verwirklichen und ihre Leidenschaft für Kreativität zu wecken! Wir sollten mit Kindern nicht über Dinge sprechen, die wir in unserem Leben nicht erreichen konnten, denn sie haben genug eigene Träume! Wir sollten von unseren Kindern nicht nur sehr gute Noten erwarten, sondern auch, dass sie ihre Hausaufgaben mit vollem Einsatz erledigen, dass sie sich im Unterricht konzentrieren, dass sie ordentlich sind und immer bereit für alle Herausforderungen, die auf sie zukommen könnten. Die Note ist eine subjektive Beurteilung mit einigen objektiven Instrumenten. Aber wir sollten daran arbeiten, dass unsere Kinder die Freiheit entwickeln, sich auszudrücken und genügend Raum für sich selbst haben. Die Welt ist groß und es gibt genug Platz für alle. Im Universum sind wir ein einzigartiges Lebewesen und niemand kann unseren vielleicht vorbestimmten Lebensraum beeinflussen. Wenn wir verwirrt sind und keine Lösung für uns und unsere Kinder haben, wenn wir enttäuscht sind von Dingen, die wir nicht kontrollieren können, die wir aber gerne anders hätten, um glücklich zu sein - dann halten wir inne! Atmen Sie tief durch und versuchen Sie, einfach Mensch zu sein. Beispiele dafür gibt es überall. Die Geschichte der Menschheit hat uns gelehrt, dass die Liebe alles besiegt. Das Gute besiegt das Böse, Anerkennung besiegt Neid und Eifersucht, Arbeit und Engagement besiegen Faulheit und Vernachlässigung. Unser Glück hängt auch vom Glück anderer ab; unser Leid verursacht auch das Leid anderer. Wenn wir im Glück und im Leid zusammen sind, werden wir sehen, wie schön diese Welt ist und wie viel Zeit wir damit verschwendet haben, sie in den dunklen Bereichen der menschlichen Seele zu suchen.

Enver Sulaj
Schulleiter "Loyola-Gymnasium”



## SI TË (MOS) IKIM NGA NJËRI-TJETRI?!



Vitet e fundit kanë qenë të veçanta e të vështira për të gjithë, ashtu si edhe për ne në Asociation "Loyola-Gymnasium". Jo çdo rrëfim, si kryefjalë duhet ta ketë pandeminë me Covid-19, por edhe qasjen tonë ndaj proceseve e fenomeneve që e kanë shoqëruar punën tonë gjatë kësaj kohe. "Të gjithë kemi ndryshuar", është pohimi që dëgjohet më së shpeshti dhe menjëherë kemi një pikë referimi për shkaqet e këtij "ndryshimi". Në të vërtetë, çka ka ndryshuar? Kësaj pyetjeje është vështirë t'i jepet përgjigje, por në disa elemente pajtohemi të gjithë. Njerëzit janë vënë në lëvizje: Nga një shtet në tjetrin, nga një regjion në tjetrin, nga një kontinent në tjetrin. Çfarë po e shkakton këtë? Përpjekja për jetë më të mirë, hapësira e pamjaftueshme për të sendërtuar ëndrrat tona apo një zbrazëti që të gjithë e ndiejmë dhe e perceptojmë në mënyrë personale? Të gjithë janë vënë në lëvizje për diku e, njëkohësisht, duke ikur nga diçka.

Bota po ndryshon. Në një kontekst të ri multipolariteti, përveç individëve, edhe shtetet po përpiqen ta (ri) gjejnë apo (ri) dizajnojnë hapësirën e vet-për interesat e tyre gjeostrategjike afatgjata e afatshkurtra? Kur harxhohen mjetet demokratike, stadi tjetër është lufta: Plot drama njerëzore, vuajtje, vrasje, tragjedi. Lufta në Ukrainë po dëshmon se barbaria njerëzore riciklohet në mënyrë periodike, ndërsa dashuria për të qenë i lirë mbetet minimumi ekzistencial i një qenieje normale.

Çdo fillim e ka një fund, për t'ia nisur përsëri nga diçka e re. Në transformimet shoqërore e zhvillimet globale, as shkolla si institucion me rëndësi jetike nuk ka mbetur pa u prekur. Dhe, problem mbi problememt mbetet përsëri edukimi dhe arsimimi. Në krejt këto zhvillime e ndryshime apo edhe transformime, mbi sistemin arsimor bie një barrë më e madhe se zakonisht. Jeta dinamike e prindërve e ka kufizuar kohën e të qëndruarit me fëmijët. Bota digjitale, përveç mureve që ne kemi krijuar, por krijon edhe barrierën tjetër-komunikimin njerëzor. Gjithçka është bërë virtuale, duke filluar nga miqësia, puna e jeta. A ka mundësi shkolla sot t'i plotësojë të gjitha këto zbrazëti e vetme? Sigurisht, që jo! Shkolla nuk mund ta kompenzojë gjirin e ngrohtë të familjes. Shkolla nuk mund ta plotësojë mungesën e afërsisë njerëzore, të shkaktuar nga distancimi social, që reflektohet në sjelljet e fëmijëve në shkollë - në intolerancën, në superegon dhe në personalitetin që është gjithmonë në lëvizje e në kërkim të diçkaje që as vet nuk e di se ç'është.

Ndryshimet dhe transformimet në një shoqëri hetohen më së lehti në sjelljet e fëmijëve. Pa marrë parasysh përgatitjen shkollore të prindërve dhe formimin e tyre, të gjithë kanë një shqetësim: Si t'i edukojmë fëmijët? Çfarë është parësore në kërkesat që duhet të kemi ndaj tyre? Çka është sjellje e pranueshme, e çka e papranueshme? Para këtyre pyetjeve askush nuk duhet të rrijë indiferent: As familja e as institucionet tjera shtetërore, duke përfshirë të parën, shkollën.

Nxënësit sot lexojnë më pak libra të detyrueshëm, por lexojnë më shumë materiale sipas dëshirës së tyre. Nxënësit sot fusin në trurin e tyre më shumë imazhe nga interneti e bota virtuale, se sa nga natyra. Nxënësit sot janë të bombarduar nga të gjitha anët me përmbajtje të cilat shkatojnë huti edhe për më të rriturit, e lëre më për ta. Dhe, përsëri dalim te vlerat! Çfarë është sot vlerë? Materialja apo shpirtërorja? Çfarë janë modelet jetësorë që u servohen nxënësve sot nga mediet, rrjetet sociale etj.? Ku është kufiri ku duhet të ndalemi e të themi: "Mjaft"! Dhe kjo, për një arsye të thjeshtë se, limitet na ndihmojnë të shohim se universi është i pafund dhe ne duhet të ndalemi në një pikë e të kënaqemi me atë që kemi e me atë që jemi!

Para objektit të shkollës rregullisht shihen prindër që i sjellin fëmijët në shkollë dhe që pas mësimit i marrin përsërime plot përkushtim e dashuri, që ata e japin sipas mënyrës së vet. Dhe, po t'i pyesësh, secili ka një shqetësim në vete dhe një dozë droje se, atë që ata vërejnë te fëmijët e tyre nuk është ajo e duhura. Dhe, përsëri vijojnë të bëjnë të njëjtën gjë, pa e ditur a po e bëjnë më të mirën për ta. Cila është më e mira, pyet secili nga ne?

Fëmijët duhet të edukohen me dashurinë për bashkëmoshatarët e tyre. Nuk duhet t'u  flasim si të bëhen të pasur,

por si të punojnë fort për të sendërtuar idetë dhe dashurinë për të qenë kreativë! Fëmijëve nuk duhet t'u flasim për gjërat që nuk kemi mundur t'i arrijmë ne në jetën tonë, sepse ata i kanë të mjaftueshme ëndrrat e veta! Nga fëmijët nuk duhet të kërkojmë vetëm nota të mira, por duhet t'u kërkojmë t'i bëjnë me përkushtim detyrat që u kërkohen, të jenë të vëmendshëm, të rregullt e të përgatitur për sfidat që u dalin përballë. Nota është vlerësim subjektiv me disa instrumente objektive, por duhet të synojmë krijimin e lirisë së shprehjes dhe krijimin e hapësirës për secilin. Bota është e madhe dhe në të ka vend për të gjithë. Në univers ne jemi qenie unike dhe askush nuk mund ta cenojë hapësirën tonë, ndoshta të paracaktuar. Nëse jemi të hutuar dhe nuk kemi zgjidhje për vete e as për fëmijët tanë; nëse jemi zhgënjyer me gjërat që ndodhin pa vullnetin tonë, e, do të donim të ishin të tilla që të na bënin të lumtur-ndaluni, merrni frymë dhe përpiquni të jeni thjesht njeri. Për këtë ka shembuj gjithandej. Historia e njerëzimib na ka mësuar se dashuria ngadhënjen mbi githçka. E mira ngadhënjen mbi të keqen, vlerësimi mbi smirën e zilinë dhe puna e përkushtimi mbi përtacinë e neglizhencën. Lumturia jonë varet edhe nga lumturia e të tjerëve; vuajtja jonë është vuajtje edhe për të tjerët. Duke qenë bashkë në vuajtje e bashkë të lumtur do ta kuptojmë se sa e bukur është kjo botë e sa shumë kohë kemi humbur duke kërkuar në zonat e errëta të shpirtit njerëzor.

Enver Sulaj,
drejtor i "Loyola-Gymnasium"



## "Wir alle verdienen eine bessere Welt".



Das ist die Botschaft, die wir dieses Jahr am Tag der offenen Tür am 7. Oktober 2022 in der Grundschule "Loyola" vermitteln wollen.

Das Thema entstand aus den starken Erfahrungen der letzten Jahre, die die Welt, die Menschheit überrollt haben. Schwierige Situationen haben jeden Menschen auf der Welt getroffen, unabhängig von seinem Ort und seiner Position, jede Familie, jedes Land, ob groß oder klein, stark oder schwach.

Zum ersten Mal in der Geschichte der Menschheit waren alle Menschen gleich und gefährdet, alle betroffen und unsicher über die ungewisse Zukunft ihrer Existenz.

Auch wir als Gesellschaft waren Teil dieser Herausforderung, die uns mit unerwarteten und völlig neuen Situationen konfrontierte.

Ein Teil der Veränderungen und neuen Herausforderungen war die Bildung selbst, eine große Veränderung in der Lehre.

Im Herbst 2019 starteten wir das Projekt Global Warming. Am Tag der offenen Tür haben wir dieses Projekt gestartet, von dem wir dachten, dass es von Dauer sein würde. Dieses Projekt zielte darauf ab, die junge Generation für den Schutz der Erde, unserem gemeinsamen Zuhause, zu sensibilisieren. Wir haben mehrere Schulungen zum Thema Abfallrecycling mit Schüler*innen gestartet. Die Kinder haben begonnen, die Recyclingkultur auch in ihren Häusern zu etablieren. Während dieser Zeit haben wir viele Dokumentarfilme über globale Erwärmung, Klimawandel und Umweltverschmutzung auf der ganzen Welt gesehen. Wir haben auch viele Aktivitäten in Zusammenarbeit mit Organisationen innerhalb und außerhalb der Schule entwickelt, um das Bewusstsein für Umweltschutz und ein gesundes Leben der Menschheit zu fördern.

Innerhalb weniger Monate erschütterte das Virus Covid 19 die Welt und schien zunächst weit weg, in China, für uns unerreichbar. Bald kam es nach Europa, bis es im Frühjahr 2020 auch unser Land traf. Es war der 12. März 2020, als die Schulen geschlossen und alle Aktivitäten eingeschränkt wurden. Als Gesellschaft befanden wir uns in einem großen Chaos. Die Nachrichten aus dem Land und der Welt waren voll von traurigen Informationen und ohne Lösungen für die Zukunft. Bildung war ein Teil dieser Herausforderung. Nach einer Weile haben wir uns mobilisiert und mit dem Unterricht über die Online-Plattform Zoom begonnen. Dies war zunächst eine Herausforderung für die Lehrer*innen und noch mehr für die Schüler*innen, einschließlich der Eltern. Diese Phase dauerte von März bis Juni. In dieser Zeit fand alles online statt, ohne physischen Kontakt zwischen Schüler*innen, Lehrer*innen und Eltern. So endete dieses Schuljahr und ließ unsere begonnenen Projekte und alle anderen schulischen Aktivitäten unvollendet zurück.

Wir begannen das neue Schuljahr 2020/21, aber nicht wie die anderen Jahre. Wir versuchten, ein normales Leben zu führen.

Es war ein anderer Start, denn die Schüler*innen kehrten nicht aus den Sommerferien zurück, die normalerweise zwei Monate dauern, sondern nach sechs Monaten, nach vier Monaten Online-Lernen in ihren Häusern und zwei Sommermonaten, kehrten sie in die Schule zurück. Sechs Monate Isolation, Isolation vom normalen Schulalltag, ohne den täglichen Weg von zu Hause zur Schule und umgekehrt, ohne Treffen mit Lehrer*innen, ohne Treffen mit Mitschüler*innen, ohne die guten und schlechten Erfahrungen des Schullebens, ohne Stolz und Freude über eine gute Leistung, Note oder Trauer über eine ungenügende Note, ohne den Jubel über den Sieg oder die Tränen über die Niederlage im Sportunterricht, ohne die Diskussionen über viele Themen im Albanisch-, Englisch- und Deutschunterricht, ohne das Erlebnis, mit Freunden spazieren zu gehen, ohne das Feiern vieler Feste und Schulaktivitäten, ohne das Konzert beim Musikfestival in der Nähe von Lumëbardhi, ohne das Erlebnis, einen Film im Kino zu sehen und ohne die vielen anderen Dinge des Schullebens. ..

Es war anders, denn aufgrund der allgemeinen Umstände begannen wir zwei Wochen später als sonst, obwohl wir

bereit waren. Am ersten Schultag trafen die Schüler*innen ihre Klassenlehrer*innen und andere Lehrer*innen an der Eingangstür der Schule; alle sehr sehnsüchtig nacheinander, aber anders, ohne die übliche Umarmung. Als die Schüler*innen ihre Klassenzimmer betraten, war die Hälfte ihrer Klassenkameraden nicht da, weil sie keine große Gruppe mehr sein konnten. Jetzt lernten sie in zwei Gruppen mit unterschiedlichen Stundenplänen, mit einem kürzeren Stundenplan als sonst, mit einigen Stunden weniger Unterricht. In der Schule lernten sie viele neue Regeln kennen, einen anderen Lebensrhythmus. Am Eingang der Schule wurde die Temperatur gemessen, man musste eine Maske tragen, man musste sich im Klassenzimmer, beim Spielen, auf dem Schulhof und überall zurückhalten, man musste sich ständig die Hände waschen und so weiter.

Es wäre anders gewesen, denn wenn wir die Schüler*innen vorher dazu ermutigt hätten, einander nahe zu sein, hätten wir ihnen sagen sollen: "Haltet Abstand". Wenn wir sie dazu erzogen hatten, Dinge zu teilen, sagten wir ihnen jetzt, dass sie keine persönlichen Dinge teilen sollten; wenn wir sie ermutigt hatten, frei zu spielen und viele Freunde zu finden, hatten wir ihnen jetzt gesagt, dass selbst das Spiel Regeln hatte und die Freunde im engen Kreis der Klassengruppe blieben.

Wenn wir sie morgens, wenn sie in die Schule kamen, ansahen, um zu sehen, ob sie glücklich waren, ob sie Sorgen hatten, mussten wir uns jetzt darauf konzentrieren, zu sehen, ob sie krank waren und ob sie ihre Masken trugen, denn wir waren es, die Angst hatten, wir mussten sie beschützen. Ungewollt wurden wir von Lehrer*innen zu Ärzt*innen, zu Sicherheitskräften, zu Menschen, die die Umsetzung eines durch die globale Situation auferlegten Protokolls kontrollieren.

Alles, was wir geplant hatten: Unterricht, pädagogische Arbeit, außerschulische Aktivitäten, Ferien usw., wir waren uns nicht sicher, ob wir es umsetzen können. Wir haben versucht, in einem ungewöhnlichen Jahr, das keine sichere Zukunft versprach, ein normales Schulleben für die Schüler*innen zu führen.

Glücklicherweise hat das Schuljahr 2022/23 für uns gut begonnen. Während der Sommerferien werden wie üblich Reparaturen und die allgemeine Reinigung der Schule durch das technische Personal durchgeführt. Bevor wir mit den Schüler*innen begannen, gab es ein Treffen mit den Lehrer*innen zur Planung und Vorbereitung des Beginns des neuen Schuljahres.

Der erste Schultag war in diesem Jahr der 1. September. Die Schüler*innen begannen um 8:00 Uhr mit dem Unterricht, mit Ausnahme der ersten Klassen, die um 10:00 Uhr starteten. Für sie wurde eine Begrüßungszeremonie organisiert, bei der die Kinder selbst sangen und tanzten. Die Jüngsten wurden von den Ältesten begrüßt; die Schüler*innen der fünften Klassen gestalteten den Festweg und gratulierten den ersten Klassen mit Liedern und Grüßen zu einem guten und erfolgreichen Start.

Wir freuen uns sehr, dass wieder Normalität einkehrt. Alles entwickelt sich wieder wie vor der Pandemie. Nach drei Jahren feierten wir den "Tag der offenen Tür" mit einem reichhaltigen Kulturprogramm, in Anwesenheit von Hunderten von Menschen, mit vielen Aktivitäten und in einer sehr guten Atmosphäre. Dieses Jahr haben wir neben den Festen und Veranstaltungen in der Schule auch viele Aktivitäten und Besuche außerhalb des Schulgeländes geplant.

Unsere Welt leidet immer. Wenn eine Sache aufhört, fängt eine andere an. Jetzt leiden wir alle mit den Menschen und Kindern in der Ukraine, die eine schwere Zeit durchmachen. Die Welt steht vor einer Wirtschaftskrise und wachsender Unsicherheit.

Ausgehend von der jüngsten Vergangenheit und der Gegenwart, die uns beunruhigt, haben wir eine große Verpflichtung, hart für ein sichereres Leben und eine bessere Zukunft für die kommenden Generationen zu arbeiten.

Ja, wir haben eine bessere Welt verdient. Alle Menschen verdienen es, in einem globalen Zuhause zu leben, in dem Sicherheit, Frieden, eine saubere Umwelt und Gleichheit herrschen. Jedes Kind, jeder Neuankömmling sollte sich willkommen fühlen und ein warmes Zuhause haben, das seinen Bedürfnissen entspricht.

Alle, ohne Ausnahme, Kinder, Jugendliche, Erwachsene, Alte, verdienen eine bessere Welt.

S. Lindita Spaqi,
Schulleiterin Grundschule "Loyola-Fillore"

## "TË GJITHË E MERITOJMË NJË BOTË MË TË MIRË"



Ky ishte mesazhi që donim ta përçonim këtë vit me rastin e "Ditës së Dyerve të Hapura" në Shkollën Fillore "Loyola", organizuar më 7 tetor 2022. Kjo temë lindi si fryt i përjetimeve të forta të viteve të fundit që pushtuan botën, njerëzimin. Situatat e vështira e kishin prekur çdo njeri në botë, pa marrë parasysh ku ndodhej dhe çfarë pozite kishte, çdo familje, secilin shtet, i vogël apo i madh, i fortë apo i dobët. Ishte e para herë në historinë e njerëzimit, ku çdo njeri ishte i barabartë dhe i rrezikuar, secili ishte i prekur dhe i pasigurtë për të ardhmen e pasigurtë të ekzistencës. Pjesë e kësaj sfide ishim edhe ne si shoqëri, ku u përballëm me situata të paprituara dhe krejtësisht të reja. Pjesë e ndryshimeve dhe përballjes me sfida të reja ishte edhe vetë arsimi; një ndryshim i madh në mësimdhënie. Në vjeshtën e vitit 2019 kishim nisur projektin për ngrohjen globale. Pikërisht në "Ditën e Dyerve të Hapura" të atij viti e patëm bërë hapjen e këtij projekti, që mendonim se do të zgjaste. Ky projekt kishte për qëllim sensibilizimin e brezave të rinj për mbrojtjen e globit - shtëpisë sonë të përbashkët. Me nxënësit e shkollës patëm nisur disa trajnime për riciklimin e mbeturinave. Kishte filluar të aplikohej shumë mirë në shkollë. Fëmijët kishin filluar të krijonin kulturën e riciklimit edhe nëpër shtëpitë e tyre. Gjatë asaj kohe kemi parë shumë filma dokumentarë në lidhje me ngrohjen globale, ndryshimet klimatike dhe ndotjen e mjedisit kudo nëpër botë. Kemi zhvilluar edhe shumë aktivitete në bashkëpunim me organizata brenda dhe jashtë shkollës, për ndërgjegjësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe jetesës së shëndetshme të njerëzimit. Pa kaluar shumë muaj, botën e tronditi Covid-19. Në fillim dukej se ishte shumë larg, në Kinën e paarritshme për ne. Shumë shpejt erdhi në Europë, derisa në pranverën e vitit 2020 preku edhe vendin tonë. Ishte data 12 mars kur u mbyllën shkollat dhe çdo aktivitet u kufizua. Si shoqëri ndodheshim në një kaos të madh. Lajmet nga vendi dhe bota sillnin shumë informacione trishtuese dhe pa ndonjë rrugë zgjidhje se ç'do të ndodhte në të ardhmen. Pjesë e kësaj sfide ishte edhe arsimi. Pas një kohe, u mobilizuam duke krijuar platformën Zoom online. Kjo ishte një sfidë, së pari për mësimdhënësit dhe aq më tepër për nxënësit, duke përfshirë edhe prindërit. Kjo periudhë zgjati nga marsi në qershor. Gjatë kësaj periudhe gjithçka zhvillohej online dhe pa asnjë kontakt fizik mes nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve. Kështu u përmbyll ky vit shkollor, duke lënë pas projektet tona të nisura dhe çdo aktivitet tjetër shkollor.

Filluam me vitin e ri shkollor 2020-2021, por jo si viteve të tjera. U përpoqëm të bënim një jetë normale. Ishte një fillim ndryshe, sepse nxënësit nuk ktheheshin nga pushimet verore që zgjasin zakonisht dy muaj, por ktheheshin në bankat shkollore pas gjashtë muajve, pas katër muajve të mësimit online në shtëpitë e tyre dhe dy muaj verë. Gjashtë muaj izolim, izolim nga jeta normale shkollore, pa bërë udhëtimin e përditshëm shtëpi – shkollë dhe anasjelltas, pa takuar mësueset dhe mësuesit, pa takuar shokët e klasës, pa përjetimet e të mirave dhe të hidhura që ka jeta shkollore, pa krenarinë dhe gëzimin e marrjes së një note të mirë apo mërzitjen e marrjes së një note jo të kënaqshme, pa bërtimat e fitores ose lotët e humbjes së lojës në orën e sportit, pa diskutimin e shumë temave në orët mësimore të gjuhës shqipe, anglishtes dhe gjermanishtes, pa përjetimin e shëtitjeve me shokë e shoqe, pa kremtimin e shumë festave dhe aktiviteteve shkollore, pa Koncertin e festës së muzikës pranë Lumëbardhit, pa përjetimin e shikimit të një filmi në kinema e shumë, e shumë të tjera nga jeta shkollore. Ishte ndryshe, sepse filluam dy javë më vonë se zakonisht, si pasojë e rrethanave të përgjithshme, edhe pse ne ishim të gatshëm për të filluar. Ditën e parë të shkollës, nxënësit i pritën mësueset kujdestare dhe mësimdhënësit e tjerë te dera e hyrjes së shkollës; të gjithë shumë të përmalluar për njëri-tjetrin, por me një ndryshim, pa përqafimin e zakonshëm. Kur nxënësit u futën nëpër klasat e tyre, gjysma e shokëve nuk ishte, sepse ata nuk mund të ishin më një grup i madh. Tani ata do të mësonin në dy grupe me orare të ndryshme, me një orar më të shkurtër se zakonisht, me disa orë mësimi të reduktuara. Në shkollë gjetën shumë rregulla të reja, një tjetër ritëm jete. Në hyrje të shkollës duhej matur temperatura, duhej të kishe maskën, duhej mbajtur distanca në klasë, në lojë, në oborr dhe kudo, duheshin pastruar duart vazhdimisht etj.

Do të ishte ndryshe sepse, nëse më parë i kishim nxitur nxënësit për afërsi me njëri-tjetrin, duhej t'u thonim: "Mba-

jeni distancën". Nëse i kishim edukuar t'i bashkëndajnë gjërat, tani u thuhej të mos i shkëmbenin gjërat personale; nëse i kishim nxitur për lojë të lirë dhe të bënin shumë miq, tani edhe loja kishte rregulla e miqtë mbeteshin rrethi i ngushtë i grupit të klasës.

# Asociation "Loyola-Gymnasium"

## REDE ZUM TAG DER OFFENEN TÜR AM 29.04.2022

Liebe Schüler*innen und Eltern,

liebe Kolleg*innen,

sehr geehrter Vorsitzender des ALG - Dr. Matthias Czech und Mitglieder des Vorstandes, die aus Deutschland angereist sind, um heute bei uns zu sein, sehr geehrter Herr Fadil Hamzaj, Vorsitzender des Elternbeirates des "Loyola-Gymnasiums".

Liebe Gäste, liebe Vertreterinnen und Vertreter der Medien, meine sehr verehrten Damen und Herren!

Vielen Dank, dass Sie zu diesem Tag der Freude und des Feierns gekommen sind.

Herzlich willkommen!

Meine Damen und Herren, heute ist für uns alle ein besonderer Tag, denn die ALG wird 17 Jahre alt. An einem schönen Apriltag vor 17 Jahren, als die Sonne den Horizont erhellte, wurde dort, wo sich heute der Campus der ALG befindet, der Grundstein für unsere Schule gelegt. Es war eine großartige Tat, den Wunsch vieler Generationen nach einer Bildungseinrichtung mit einem klaren Auftrag zu erfüllen: Bildung und Erziehung, die durch engagierte Arbeit und Leistung eine unverwechselbare Identität erhält, die uns alle glücklich macht.

Der Weg, den wir seit fast zwei Jahrzehnten beschreiten, und die Erfolge, die wir erzielt haben, haben wir gemeinsam mit Ihnen, liebe Eltern, erreicht, denn Ihr Vertrauen in uns ist uns Ansporn und Verpflichtung, aber auch Verantwortung in der edlen Aufgabe des Lehrers, junge Menschen heranzubilden, die die Last des Aufbaus unseres Landes tragen werden.



An diesem besonderen Tag ist es notwendig, uns daran zu erinnern, dem deutschen Volk dafür zu danken, dass es dem Kosovo das wertvollste Geschenk nach dem Krieg gemacht hat - diesen Tempel des Wissens, der auch unsere Verbindung zu Europa ist, unsere Wiege und unsere schützende Ikone, die uns immer in den schlimmsten Tagen unseres Schicksals geholfen hat.

Das Mosaik unserer Erfolge wäre unvollständig ohne die Unterstützung unserer lokalen und zentralen Institutionen, denn wir sind Teil eines Ganzen, mit gemeinsamen Sorgen und Anliegen - eine bessere und wohlhabendere Welt für alle zu schaffen.

Sehr geehrte Damen und Herren, der 17. Geburtstag des ALG "Loyola-Gymnasium" ist nicht nur eine Zahl, eine Zeitmarke, er ist mehr als das - er ist eine Seite der Geschichte, der Opfer, die die Gründer dieses Projekts gebracht haben, das bereits über seine ursprünglichen Ziele hinausgewachsen ist.

Wenn die Schule in ihren Anfängen, in der Antike, aus dem Bedürfnis geboren wurde, Erfahrungen von einer Generation an die nächste weiterzugeben, um Lösungen für die Probleme und Sorgen des Alltags zu finden, so müssen wir als Pädagogen heute innehalten und ernsthaft darüber nachdenken: Werden wir diesem Bedürfnis gerecht?

Die Geschichte hat gezeigt, dass es nicht die Masse ist, die etwas verändert, sondern Individuen mit freiem Willen und offenem Geist, die hart für sich selbst und für andere arbeiten. In diesem Sinne bleiben unsere Ziele unverändert: Für diese jungen Menschen, die jeden Tag unseren Campus beleben, setzen wir uns ein, damit sie eine moderne Ausbildung erhalten und den Horizont des Wissens erobern.

Auf der anderen Seite wollen wir nicht die Illusion von Lösungen wie mit einem Zauberstab herbeizaubern, sondern sind überzeugt, dass die Kraft des menschlichen Gehirns genügend Raum für ein menschenwürdiges Leben und Arbeiten schaffen kann. Deshalb fördern wir in unserer Schule kritisches Denken, selbständiges Arbeiten durch einen ganzheitlichen Ansatz und akzeptieren uns gegenseitig mit unseren Eigenheiten und Werten.

Nicht nur Wissen, sondern auch sittliche Vollkommenheit, Menschenliebe und Vorbereitung auf das Leben - das bleibt unsere Aufgabe und unser Anliegen als schulische Institution.

Liebe Eltern, das letzte Mal haben wir uns im April 2019 in diesem schönen Amphitheater getroffen, denn die Pandemie Covid-19 hat uns der Versammlungen beraubt, so dass ein Feiertag wie heute auch eine Erinnerung an schöne Tage ist, an Hoffnungen voller Liebe, an die Nähe.

Wir arbeiten hart, um mit der Zeit Schritt zu halten, denn die Zeit erfordert eine neue Herangehensweise und einen neuen Geist, denn neu sind die Anliegen und die Ziele, um auf die Herausforderungen der Zeit zu reagieren.

Zusammen können wir alles erreichen!

Abschließend möchte ich Ihnen nochmals dafür danken, dass Sie heute gekommen sind, um mit uns das 17-jährige Bestehen des Loyola-Gymnasiums zu feiern.

Enver Sulaj,
Direktor des "Loyola-Gymnasium"





## DIJE, PËRSOSMËRI MORALE E DASHURI NJERËZORE - KY MBETET MISIONI I "LOYOLA - GYMNASIUM"

*Fjalim i mbajtur para të pranishmëve, në programin festiv për nder të "Ditës së Dyerve të Hapura"*

Të nderuar nxënës e prindër,

të nderuara kolege e kolegë,

i nderuar kryetar i Bordit të ALG-së, z. Matias Czhec dhe ju anëtarë të Kuvendit dhe të Bordit të ALG-së që keni udhëtuar nga Gjermania për të qenë sot këtu bashkë me ne, i nderuar z. Fadil Hamzaj, kryetar i Këshillit të Prindërve të "Loyola-Gymnasium"!

Të nderuar mysafirë të shumtë, të nderuar përfaqësues të medies, të nderuara zonja dhe zotërinj! Ju falënderoj përzemërsisht për praninë tuaj, në këtë ditë gëzimi e feste. Mirë se keni ardhë!

Të nderuar të pranishëm, sot është një ditë e veçantë për të gjithë ne, sepse ALG mbush 17 vjet. Një ditë të bukur prilli, nën rrezet e diellit që po ndriçonte horizontin ku sot shtrihet kampusi i ALG-së, 17 vjet më parë, u vu gurthemeli i shkollës sonë. Ishte ky një akt madhështor, për të përmbushur dëshirën e brezave të shumtë për një institucion arsimor me mision të qartë: arsimimin dhe edukimin, i cili tashmë ka krijuar një identitet të veçantë, përmes punës me përkushtim e arritjeve, që na bëjnë të lumtur të gjithëve.

Rrugën që e kemi bërë për gati dy dekada dhe suksesi që kemi arritur, e kemi bërë bashkë me ju, të dashur prindër, sepse besimi juaj është nxitje dhe detyrim për ne; është edhe përgjegjësi në misionin fisnik të mësimdhënësit, për t‘i dhënë formë njeriut të ri, që do ta bartë barrën e ndërtimit të vendit tonë.

Në këtë ditë të shënuar, është e domosdoshme ta rifreskojmë mbamendjen tonë, për të kujtuar e falënderuar popullin fisnik gjerman, që Kosovës të sapodalë nga lufta i ka dhënë dhuratën më të çmuar-këtë tempull dijeje që, është njëkohësisht edhe lidhja jonë me Europën, me kontinentin mëmë, që është djepi dhe ikona jonë mbrojtëse, ashtu siç është dëshmuar gjithmonë në ditët më të liga të fatit tonë.

Mozaiku i suksesve tona do të ishte i paplotë pa mbështetjen edhe të institucioneve tona, lokale e qendrore, sepse ne jemi pjesë e këtij nënqielli, me brenga dhe preokupime të përbashkëta-për të ndërtuar një botë më të mirë e më të begatshme për të gjithë.

Të nderuar të pranishëm, ditëlindja e 17-të e Asociation "Loyola-Gymnasium" nuk është thjesht një numër, një shenjëzues kohe, është më tepër se kaq - është një faqe historie, ku mësojmë për sakrificën e ideatorëve dhe realizuesve të këtij projekti që tashmë ka kaluar caqet lokale.

Nëse në fillet e saj, në antikitet, shkolla lindi si nevojë e bartjes së përvojës nga një brez te tjetri, për të ofruar zgjidhje për problemet dhe shqetësimet e përditshme, atëherë, ne, sot, si pedagogë duhet të ndalemi dhe të mendojmë seriozisht: A po e përmbushim këtë përgjegjësi që e kemi ndaj brezave të tanishëm dhe atyre që do të vijnë. Historia ka dëshmuar se, ndryshimet nuk i bëjnë turmat, por individët me vullnet të lirë e mendje të hapur, duke punuar fort për veten e për të tjerët. Në këtë linjë,



synimi ynë mbetet konstant: Këta të rinj e të reja që i japin gjallëri kampusit tonë sot, e përditë, angazhohemi që të marrin formimin modern, të edukohen si vullnete të lira, për të pushtuar horizontet e dijes e për ta bërë më të bukur e më të përparuar këtë vend. Në anën tjetër, ne nuk duam të krijojmë iluzionin e zgjidhjeve si përmes shkopit magjik - por jemi të bindur se fuqia e trurit të njeriut mund të krijojë hapësira të mjaftueshme, për një jetë e punë të dinjitetshme. Për këtë arsye, ne, në shkollën tonë e nxisim të menduarit kritik, punën e pavarur, përmes qasjes gjithëpërfshirëse, duke e pranuar njëri - tjetrin me veçantitë dhe vlerat që kemi.

Jo vetëm dije, por edhe përsosmëri  morale, dashuri njerëzore e përgatitje për jetën - ky mbetet misioni dhe preokupimi ynë si institucion shkollor.

Të nderuar prindër, për herë të fundit, në këtë amfiteatër të bukur jemi takuar në prill të 2019-tës, për shkak se pandemia me Covid-19 na ka privuar nga tubime të hapura e masovike, prandaj një festë si kjo sot, është njëkohësisht edhe ritkhim i ditëve të bukura, i shpresës, mbushur me dashuri, për të qenë pranë njëri - tjetrit, për të festuar e për t'u gëzuar me hiret që na ka dhuruar Zoti. Poashtu, po punojmë fort për ta ruajtur hapin me kohën, sepse koha kërkon qasje e frymë të re, sepse të reja janë edhe preokupimet dhe synimet për t'iu përgjigjur sfidave të kohës.

Bashkë mund t'i arrijmë të gjitha!

Më lejoni që, në përmbyllje, t'ju falënderoj edhe njëherë për praninë tuaj sot, për t'u gëzuar e për të festuar së bashku me ne 17-vjetorin e Asociation "Loyola-Gymnasium".

Enver Sulaj,
drejtor i "Loyola-Gymnasium"






ALG
Loyola - Gymnasium


-Gymn
A
L
G

## EIN JAHR VOLLER AKTIVITÄTEN UND ERFOLGE FÜR UNSERE SCHÜLERINNEN



Das Schuljahr 2021/22 am Loyola-Gymnasium war ein Jahr mit herausragenden Ergebnissen im Bildungsprozess. In diesem Jahr haben wir unsere Ziele in allen Bereichen erreicht, aber wir werden nicht aufhören, die Besten zu sein. Dafür gilt ein besonderer Dank den SchülerInnen, den LehrerInnen, der Schulleitung und den ErzieherInnen unseres Internats.

Wenn wir es chronologisch betrachten, müssen wir auf jeden Fall den Beginn des Schuljahres hervorheben, da zum ersten Mal neue SchülerInnen der 6. und 10. Klasse in unsere Schule und unser Internat kamen. Jeder Schuljahresbeginn ist eine neue Erfahrung, ein neuer Weg voller unbekannter Ereignisse, aber jeder Beginn hat ein klares Ziel - die Zukunft dieses Landes weiter aufzubauen. Die Kinder brauchen unsere Liebe, Unterstützung und ständige Hilfe. Das Loyola-Gymnasium bleibt seinem Auftrag verpflichtet: Wissen und die nötige Wärme zu vermitteln und gleichzeitig eine freundliche und gleichberechtigte Umgebung für alle zu schaffen.

Viele Ereignisse haben zu zufriedenstellenden Ergebnissen geführt.  Besonders hervorzuheben ist unser Engagement für das Erlernen von Fremdsprachen wie Deutsch, Englisch und Latein. Wir haben immer mehr Schülerinnen und Schüler, die sich mit ihren Lehrerinnen und Lehrern für das Erlernen der deutschen Sprache engagieren. Die Ergebnisse dieser Arbeit sind hervorragend. Auch in diesem Schuljahr wurden große Schritte in Richtung DSD gemacht! Wir gratulieren den SchülerInnen und LehrerInnen des ALG Loyola-Gymnasiums zum erfolgreichen Bestehen der schulinternen Prüfungen A1 und A2. Respekt für die 200 SchülerInnen, die es erfolgreich bestanden haben. Diese interne Prüfung dient nicht nur als Zwischenergebnis für die nächste DSD I- oder B1-Prüfung, sondern auch als Feedback für die Eltern, um die Entwicklung ihrer Kinder zu verfolgen, und als Feedback für die ZfA (Zentralstelle für das Auslandsschulwesen), da diese Prüfungen in Deutschland geschrieben und die Ergebnisse nach Deutschland zurückgeschickt werden.

Nach dem Fortgang der Arbeit am Loyola-Gymnasium ist das Engagement von LehrerInnen und SchülerInnen im außerschulischen Lernen hervorzuheben. Wir hatten einen Austausch mit OberstufenschülerInnen aus Sarajevo und 15 unserer SchülerInnen waren dort im Rahmen des von der EU geförderten Projektes "Super Schools", wo die SchülerInnen viele ihrer innovativen Fähigkeiten aus unterschiedlichen Wissensbereichen umgesetzt haben.

Auch in diesem Schuljahr kommt der Moment, wo die Maturantinnen und Maturanten uns verlassen, um neue Lebenswege zu beginnen. Unsere AbsolventInnen haben ihre Ausbildung am Loyola-Gymnasium mit Stolz auf das Erreichte, aber auch mit den natürlichen Emotionen, die einen solchen Tag prägen, abgeschlossen. Es war eine Reise voller Träume und Hingabe, um das notwendige Wissen zu erwerben.





"Liebe Abiturientinnen und Abiturienten, wir wünschen euch von Herzen viel Erfolg und Wohlergehen auf euren neuen Lebenswegen", gratulierte der Direktor des Loyola-Gymnasiums, Herr Enver Sulaj.

Vor allem wir als Schule erlebten eine außergewöhnliche Begeisterung, als unsere Neuntklässler die Ergebnisse der (mittleren) Reifeprüfung erhielten. Mit 100% bestandenen Prüfungen und einer Erfolgsquote von 81% der neunten Klassen des ALG. Gute Arbeit führt zu guten Ergebnissen! "Herzlichen Glückwunsch, liebe SchülerInnen und KollegInnen! Viel Erfolg!"

Ein ähnliches Ergebnis haben wir auch bei der Reifeprüfung in der 12. Klasse mit einer Erfolgsquote von 100 % und einer Leistungsquote von über 81 %. Wir sind stolz auf diese Ergebnisse.

Wir hatten auch festliche Momente wie den 17. Februar - den Unabhängigkeitstag der Republik Kosovo, den Tag der offenen Tür und den 28. November - den Tag der Nationalflagge. An all diesen feierlichen Anlässen präsentierten die SchülerInnen, unterstützt von unseren LehrerInnen, interessante kulturell-künstlerische Programmpunkte.

Es ist schwierig, in einem kurzen Artikel alle Aktivitäten zu erwähnen, die das Schuljahr 2021/22 geprägt haben, daher sind die bisher erwähnten Veranstaltungen nur ein Teil davon. Wir verpflichten uns, unsere Arbeit mit SchülerInnen, Eltern und anderen Organisationen in der Exzellenz des Lernens und Lehrens fortzusetzen, um unsere edle Mission zu erfüllen, die das Loyola-Gymnasium ausmacht.

Fadil Bytyçi,
Prof.

## NJË VIT I MBUSHUR ME AKTIVITETE E SUKSESE TË NXËNËSVE TANË

Viti shkollor 2021-2022 në "Loyola-Gymnasium" ishte një vit që shënoi rezultate të jashtëzakonshme në procesin edukativo - arsimor. Ky vit përmbushi synimet tona në të gjitha fushat, megjithatë ne nuk do të pushojmë të jemi më të mirët. Për këtë një falënderim i veçantë u drejtohet nxënësve, mësimdhënësve, menaxhmentit dhe stafit përcjellës të shkollës sonë.

Po të shikohet kronologjikisht, nuk mund të mos e theksojmë edhe fillimvitin shkollor, kur për herë të parë në shkollën tonë dhe konvikte erdhën nxënës të rinj nga klasa e gjashtë dhe nga klasa e dhjetë. Çdo fillim i vitit shkollor është një përjetim i ri, një sprovë e re dhe një rrugë plot të panjohura, që ka një synim të qartë-ndërtimin e së ardhmes. Fëmijët kanë nevojë për dashurinë tonë, mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme. "Loyola-Gymnasium" mbetet e përkushtuar në përmbushjen e misionit të saj: ofrimin e dijes, ngrohtësisë së nevojshme dhe krijimit të një ambenti miqësor e të barabartë për të gjithë.

Ngjarjet që shënojnë rezultate të kënaqshme janë të shumta. Megjithatë, duhet veçuar edhe përkushtimin tonë për mësimin e gjuhëve të huaja, si gjermane, angleze dhe latine. Në këtë vazhdë gjithnjë e më shumë kemi nxënës që tregojnë përkushtimin e tyre dhe të mësimdhënësve për mësimin e gjuhës gjermane. Në shkollën tonë organziohen edhe kurset për zotërimin e kësaj gjuhe dhe në këtë vazh-

dë të punës janë arritur rezultate të shkëlqyeshme.

Me hapa të mëdhenj drejt DSD-së!

Urime nxënësve dhe mësuesve të ALG "Loyola-Gymnasium" për punën e kryer me sukses të provimit të brendshëm A1 dhe A2. Respekt për 200 nxënësit që e kaluan me sukses. Ky provim i brendshëm shërben jo vetëm si një rezultat i ndërmjetëm për provimin e ardhshëm DSD I ose B1, por edhe si reagim për prindërit që të ndjekin zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe si reagim për ZfA (Zyrën Qendrore për shkollat jashtë vendit), pasi këto provime janë krijuar në Gjermani dhe rezultatet kthehen në Gjermani.

Duke ndjekur tutje ecurinë e punës në "Loyola-Gymnasium" duhet veçuar edhe angazhimin e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësimin jashtëkurrikular. Patëm këmbim me nxënësit e gjimnazit nga Sarajeva dhe 15 nxënës tanë ishin atje në kuadër të projektit të mbështetur nga BE, "Super Shkolla"  si dhe projektin "Toka", ku nxënësit zbatuan







shumë shkathtësi të tyre inovative nga fusha të ndryshme të dijes.

Gjatë këtij viti shkollor, si edhe më parë, vjen momenti kur maturantet shkëputen nga ne për t'iu qasur rrugëve të reja të jetës. Maturantët tanë e kanë përmbyllur shkollimin në "Loyola-Gymnasium", krenarë për arritjet e deritanishme, por edhe me emocionet e natyrshme që e shënojnë një ditë të tillë.  Ishte një rrugëtim plot ëndrra e përkushtim, për të nxënë dijen dhe formimin e nevojshëm.

"Të dashur maturantë, nga zemra ju dëshirojmë suksese e mbarësi në rrugët e jetës dhe sprovat e reja!,- ishte urimi i drejtorit të "Loyola-Gymnasium, prof. Enver Sulaj.

Një ekzaltim të jashtëzakonshëm përjetuam në veçanti, ne, si shkollë, kur nxënësit tanë të klasave të nënta morën rezultatet e provimit të arritshmërisë, ku kalueshmëria ishte 100%. Puna e mirë sjell rezultate të mira! Urime nxënës dhe kolege e kolegë të nderuar! Suksese!

Po një rezultat të tillë morëm edhe në Provimin Shtetëror të Maturës për klasat e 12-ta, ku kalueshmëria ishte 100%, ndërsa arritshmëria mbi 81%. Këto rezultate na bëjnë të ndihemi krenarë të gjithë.

Patëm edhe momente festive, siç është 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Dita e  Dyerve te Hapura dhe festa e 28 Nëntorit -Dita e Flamurit Kombëtar. Në të gjitha këto festa nxënësit, të përkrahur nga arsimtarët tanë shfaqën programe të këndshme kulturore-artistike, aktivitete tjera mësimore nga fushat e shkencave, etj.

Brenda një artikulli të shkurtër është e vështirë të përfshihen të gjitha aktivitetet që e karakterizojnë vitin shkollor 2021-22, por këto që thamë me lart janë vetëm disa nga segmentet e këtyre aktiviteteve. Jemi të përkushtuar që të vazhdojmë punën tonë me nxënësit, prindërit dhe organizatat tjera, në përsosmërinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies, për të kryer misionin tonë fisnik, që e mëton "Loyola-Gymnasium".

Fadil Bytyçi,
prof.



## IN EINER FEIERLICHEN VERANSTALTUNG ERHIELTEN DIE ABITURIENTINNEN UND ABITURIENTEN DES "LOYOLA-GYMNASIUMS" IHRE ABSCHLUSSZEUGNISSE

In einer feierlichen Veranstaltung und in Anwesenheit von Lehrkräften und Eltern erhielten unsere Abiturient*innen am 4. Juli 2022 ihre Diplome über den Abschluss des "Loyola-Gymnasiums”.

Die hundertprozentige Erfolgsquote bei den Abiturprüfungen, das kontinuierliche Engagement in den Projekten und die verschiedenen sozialen Aktivitäten zeigen uns, dass sich gute Arbeit trotz unzähliger Schwierigkeiten und Herausforderungen lohnt.

Die Schüler*innen, die hohe Ergebnisse erzielt und ein vorbildliches soziales Verhalten gezeigt haben, erhielten Bücher bekannter Schriftsteller als Geschenk. Zum Abschluss fand ein Empfang für die anwesenden Gäste statt.

Wir wünschen den Abiturient*innen Gesundheit, Glück und viel Erfolg auf ihrem weiteren Lebensweg!

## NË NJË CEREMONI SOLEMNE, MATURANTËVE U SHPËRNDAHEN DIPLOMAT E PËRFUNDIMIT TË SHKOLLIMIT NË "LOYOLA-GYMNASIUM"

Në një ceremoni solemne, më 4 korrik 2022, në prani të mësimdhënësve dhe prindërve, maturantët tanë kanë marrë diplomat, me të cilat e përmbyllën shkollimin në "Loyola-Gymnasium".

Kalueshmëria 100% në Testin e Maturës Shtetërore, angazhimi i pareshtur në projekte dhe veprimtari të ndryshme shoqërore, megjithë sprovat e panumërta, dëshmojnë më së miri se puna e mirë shpërblehet.

Nxënësit me rezultate të larta në mësime dhe më të dalluarit në sjelljet shoqërore u shpërblyen me libra të autorëve të njohur, ndërsa për të gjithë të pranishmit në fund u organizua një koktej rasti.

Maturantëve u dëshirojmë shëndet, gëzime e suksese! I paçin të bekuara rrugët e jetës!





## BEGEGNUNG MIT KÜNSTLERN

Zu Ehren des "Tages der offenen Tür" organisierten Mitglieder*innen der Albanisch-Fachschaft nach dem zentralen Programm eine Lesung. Ein besonderes Treffen der Schüler*innen mit Künstlern und Kulturschaffenden aus der Region Prizren, wie z.B. Nexhat Çoçaj (Schriftsteller und Forscher), Salajdin Krasniqi (Dichter), Osman Goranci (Dichter und Dramatiker), Rabie Bytyçi (Dichter), Arben Rashkaj (Dichter), Sinan Aliaj (Bildhauer), Xhevdet Doda (Schauspieler) und Kemajl Rysha (Schauspieler).

Moderiert wurde die Lesung vom ältesten Dichter und Lehrer unserer Fachschaft, Prof. Skënder Berisha, der sich bei den Schriftstellern und Künstlern bedankte und den Anwesenden biografische Informationen über das Leben, Wirken und Schaffen unserer Gäste vermittelte.

Für die Schüler*innen des "Loyola-Gymnasiums" war das Gespräch mit den Schriftsteller*innen und Künstler*innen sehr beeindruckend. Sie waren sehr neugierig und stellten ohne zu zögern Fragen über die Kunst des Schauspiels, den Prozess des künstlerischen Schaffens, die Arbeit der Schriftsteller, woher die Künstler die Inspiration für ihre Arbeit bekommen, den Einfluss der Künstler auf die Leser durch ihre Arbeit und andere Themen.

Und die Künstler*innen antworteten mit viel Liebe auf die Fragen der Schüler*innen. In ihrer Rede zu diesem Anlass legten sie besonderen Wert auf das Lesen und forderten die Schüler*innen daher auf, sich möglichst von sozialen Netzwerken fernzuhalten oder diese nur eingeschränkt zu nutzen, um ein Buch nicht abzubrechen und viel und intensiv für ihre Zukunft zu arbeiten.

Begleitet wurde das Publikum von Gitarrenklängen und Gedichten aus dem reichen Repertoire unserer geladenen Gäste, liebevoll interpretiert von unseren talentierten Schüler*innen.

Wir danken ihnen von ganzem Herzen für die kostbare Zeit, die sie mit uns geteilt haben.




## TAKIMI ME ARTISTËT

Për nder të Ditës së Dyerve të Hapura, pas programit qendror, anëtarët e Aktivit të Gjuhës shqipe organizuan orë letrare, takim të veçantë të nxënësve me artistë e krijues nga treva e Prizrenit, si: Nexhat Çoçaj (shkrimtar

e studiues), Salajdin Krasniqi (poet), Osman Goranci (poet e dramaturg), Rabie Bytyçi (poete), Arben Rashkaj (poet), Sinan Aliaj (skulptor), Xhevdet Doda (aktor) dhe Kemajl Rysha (aktor).

Ora letrare udhëhiqej nga poeti dhe profesori më i vjetër i aktivit tonë, prof. Skënder Berisha, i cili i falënderoi shkrimtarët e artistët, të cilët na nderuan me pjesëmarrjen e tyre, kurse për të pranishmit ndau të dhëna biografike që lidheshin me jetën, veprimtarinë dhe veprën e mysafirëve tanë. Për nxënësit e "Loyola-Gymnasium", bashkëbisedimi me shkrimtarët e artistët ishte mjaft mbresëlënës.

Ata u treguan tejet kureshtarë, nuk hezituan të parashtronin pyetje lidhur me artin e aktrimin, me procesin e artit krijues, veprën e autorëve, lidhur me atë se ku e gjejnë frymëzimin artistët për të krijuar, ndikimin e artistëve te lexuesit përmes veprës së tyre e të tjera çështje me interes për ta. Kurse artistët, me shumë dashuri dhanë përgjigje për pyetjet e nxënësve.

Në fjalën e tyre të rastit, ata vunë theksin e veçantë te të lexuarit, ndaj kërkuan nga nxënësit që të qëndrojnë sa më larg rrjeteve sociale, për sa të jetë e mundur, ose t'i përdorin ato me kufizime, me qëllim që të mos e braktisin librin, si dhe të punojnë fort për të ardhmen e tyre.

Shoqëruar me tingujt kitare, për të pranishmit, u recituan poezi nga repertori i pasur i mysafirëve tanë, poezi, të cilat u interpretuan me mjaft dashuri nga nxënësit tanë të talentuar.

## "TAG DER OFFENEN TÜR" - TAG DER EXPERIMENTE

Dieses Jahr haben wir, Alma Ademaj 10b, Arvena Qovanaj 10b und Endrit Tytynxhiu 10a am Tag der Schule am Chemieprojekt teilgenommen. Wie jedes Jahr wurden verschiedene Experimente von den Teilnehmern der Chemiegruppe durchgeführt. Mein Experiment hieß "Elefantenzahnpasta". Dieses Experiment beschreibt eine exotherme Reaktion, d.h. es wird Wärme freigesetzt. Um dieses Experiment durchzuführen, mussten wir $KMnO_4$ und pulverisiertes Zink in einer bestimmten Menge mit Wasser in einem Laborglas mischen. Dann haben wir in ein anderes Laborglas $H_2O_2$ und Spülmittel (zum Aufschäumen) gegeben. Dadurch entstand eine zusätzliche Oberflächenspannung, die die Blasen blockierte und viel Schaum entstehen ließ. Vorher gaben wir eine beliebige Farbe hinzu. In dem Moment, in dem $H_2O_2$ und $KMnO_4$-Lösung gemischt wurden, sahen wir, wie ein Vulkan aus farbigem Schaum entstand.







Das andere Experiment, das ich entwickelt habe, war "Rotkohlsaft als Indikator". Es zeigte, wie man mit einem organischen Indikator die relevanten Milieus (sauer, neutral, basisch) unterscheiden kann. Wir haben Rotkohlsaft als Indikator in viele Erlenmeyerkolben gegeben. Dann haben wir verschiedene Basen und Säuren hinzugefügt, um zu sehen, wie sich die Farben verändern. NaOH (blaue Farbe), $H_2O$ (neutrale Umgebung), Reinigungsmittel (blau / Base), Essig (rot / Säure), HCl (dunkelrot / rosa - starke Säure). Daraus schlossen wir, dass die rote Farbe die saure Umgebung und die blaue Farbe die basische Umgebung darstellt, während die neutrale Umgebung zwischen diesen beiden Farben liegt.

Das andere Experiment wurde von Arvena Qovanaj 10b durchgeführt. Sie führte eine der Trennmethoden der Chemie, die Extraktion, durch. Die Extraktion ist ein Verfahren zur Trennung von Bestandteilen eines Gemisches auf der Grundlage von Unterschieden in der Löslichkeit in verschiedenen Lösungsmitteln. Sie entwickelte auch das Experiment "Lavalampe". Zuerst gab sie Backpulver in ein Reagenzglas und fügte dann Wasser, Öl und die gewünschte Farbe hinzu. Öl schwimmt auf dem Wasser, weil es eine geringere Dichte hat bzw. leichter ist als Wasser. Die Lebensmittelfarbe hat die gleiche Dichte wie Wasser, sinkt also in das Öl und vermischt sich mit dem Wasser. Als sie die Tablette hinzufügte, sank sie zu Boden und begann sich aufzulösen. Bei der Auflösung entstand Kohlendioxid als Gas. Gas ist leichter als Wasser und steigt deshalb auf. Die Luftblasen nehmen etwas gefärbtes Wasser mit nach oben. Als die Luft aus dem Schmutzwassertropfen entwich, wurde das Wasser wieder schwerer und sank nach unten. Dieser Vorgang wird so lange wiederholt, bis sich die Tablette vollständig aufgelöst hat.

Endrit Tytynxhiu 10a führte das Experiment "Rückverwandlung einer Kupfermünze in Silber und Gold" durch.

Alma Ademaj, Klasse 10/B

## "DITA E DYERVE TË HAPURA" - DITA E EKSPERIMENTEVE INTERESANTE NË LABORATORIN E KIMISË

Këtë vit, unë, Alma Ademaj, kl. 10/B, Arvena Qovanaj, kl. 10/B dhe Endrit Tytynxhiu, kl. 10/A ishim pjesë e projektit të kimisë në kuadër të aktiviteteve të oganizuara për nder të ditës së shkollës. Sikurse çdo vit tjetër u realizuan eksperimente të ndryshme nga pjesëmarrësit e grupit të kimisë. Eksperimenti im titullohej "Pasta e dhëmbëve të elefantit". Ky ekperiment përshkruante një reaksion ekzotermik, që do të thotë se lironte nxehtësi. Për realizimin e këtj ekperimenti duhej të përzienim $KMnO_4$ dhe zinkun pluhur në ujë, në sasi të caktuar në gotën laboratorike. Më pas, në një gotë tjetër laboratorike vendosnim $H_2O_2$ dhe shampo (për shkumëzim) i cili siguron tension shtesë sipërfaqësor, duke lejuar që më pas fluskat të bllokohen dhe të krijojnë shumë shkumë. Paraprakisht shtohet dhe ngjyrë e çfarëdoshme. Në momentin kur në $H_2O_2$ e derdhëm tretësirën e $KMnO_4$, shihnim se si krijohej një vullkan shkume me ngjyrë. Eksperimenti tjetër të cilin e zhvillova ishte "Lëngu i lakrës së kuqe si indikator" i cili sqaronte se si me një indikator organik mund t'i dallonim apo veçonim mjediset përkatëse (acidike, neutrale, bazike). Në shumë erlenmajera vendosëm lëng të lakrës së kuqe, i cili shërbente si indikator dhe më pas vendosëm baza dhe acide të ndryshme, duke parë se si ndryshonin ngjyrat. NaOH (ngjyrë e kaltër), $H_2O$



(mjedis neutral), detergjent (e kaltër/bazë), uthull (e kuqe/ acid), HCl (e kuqe e ndezët/pembe - acid i fortë). Pra, nga kjo konstatuam se ngjyra e kuqe paraqiste mjediset acidike dhe ato kah e kaltërta bazike, kurse ndërmjet këtyre dy ngjyrave mjedisi neutral.

Eksperimenti tjetër u realizua nga Arvena Qovanaj, nxënëse e kl. 10/B. Ajo realizoi njërën nga metodat e ndarjes në kimi-ekstraktimin. Ekstraktimi është një metodë e ndarjes së komponenteve nga përzierja e cila vazohej në dallimet në tretshmërinë e tyre në tretës të ndryshëm. Ajo, gjithashtu, zhvilloi eksperimentin "Lava lamp". Fillimisht ka marrë epruvetën në të cilën vendosi sodën e bukës dhe pastaj shtoi ujë, vaj dhe ngjyrën e dëshirueshme. Vaji noton mbi ujë, sepse është më pak i dendur ose më i lehtë se uji. Ngjyrosja e ushqimit ka të njëjtën densitet si uji, kështu që zhytet në vaj dhe përzihet me ujin. Kur shtoi tabletën, ajo zhytej në fund dhe më pas filloi të shpërndahet. Ndërsa shpërndahej, prodhonte gaz dioksid karboni. Gazi ose ajri është më i lehtë se uji, kështu që noton sipër. Fluskat e ajrit sjellin me vete pak ujë me ngjyrë në majë. Kur ajri doli nga pika e ujit me ngiyrë, uji rëndohej përsëri dhe fundoset. E bënë këtë pa pushim derisa tableta të tretej plotësisht. Në vazhdim të aktiviteteve tona për nder të "Ditës së Dyerve të Hapura", Endrit Tytynxhiu, nxënës i kl.10/A realizoi eksperimentin lidhur me kthimin e monedhës së bakrit në ngjyrë argjendi dhe ari.

Alma Ademaj, kl. 10/B





## LABORVERSUCH, DER DIE WICHTIGKEIT DES WALDSCHUTZES ZEIGT

Der "Tag der offenen Tür" ist einer der wichtigsten und interessantesten Tage unserer Schule. An diesem Tag öffnen wir unsere Türen für alle, die sehen wollen, was wir machen. Wir begrüßen alle mit verschiedenen Aktivitäten und lassen sie die schöne Atmosphäre an jeder Ecke der Schule spüren. Und natürlich haben wir als Schüler*innen dieser Schule an diesen Aktivitäten teilgenommen. Unter anderem haben wir ein Forschungsexperiment im Fach Chemie durchgeführt.

Die Vorbereitungen für dieses Experiment, das am "Tag der offenen Tür" so gut wie möglich präsentiert werden sollte, waren lang und voller Überraschungen. Zusammen mit unseren Lehrer*innen haben wir stundenlang gearbeitet, um die genauesten Ergebnisse zu erzielen. Die Arbeit im Labor kann anstrengend sein, aber die Atmosphäre, die wir während der Vorbereitungen geschaffen haben, hat uns nie müde werden lassen. Das Experiment erforderte viel Verantwortung und Engagement, da ein kleiner Fehler während des Prozesses zu falschen Ergebnissen führen würde, aber unsere Lehrer*innen waren immer da, um sicherzustellen, dass alles gut lief und wir unsere Arbeit im Wesentlichen verstehen konnten.

Das Experiment, das wir durchgeführt haben, heißt "Messung der Intensität der Photosynthese nach der chemischen Methode von Winkler". Mit dieser Methode konnten wir in kurzer Zeit (eine Stunde) genau bestimmen, wie viel Sauerstoff uns ein Wald liefert. Das zeigte uns die große Bedeutung der Wälder und schärfte unser Bewusstsein, sie nicht unkontrolliert abzuholzen. Obwohl wir jeden Tag von der Bedeutung des Waldes hören, wird uns diese Bedeutung erst durch die eigene Beobachtung bewusst. Wir hoffen, dass das Beobachten dieses Experiments auf alle, die dabei waren, den gleichen Effekt hatte. Am "Tag der offenen Tür" war das Chemielabor voll mit neugierigen Menschen, die unsere vorbereiteten Experimente sehr genau beobachteten. Neben dem eigentlichen Ziel hat uns diese Erfahrung gezeigt, wie sehr uns die Arbeit im Labor gefällt. Wir können sagen, dass es eine unserer Lieblingserfahrungen war und wir sind sehr froh, dass wir die Möglichkeit hatten, daran teilzunehmen.

Ejona und Viola Rexhepi, Klasse 12/A



## EKSPERIMENTET LABORATORIKE NË FUNKSION TË NDËRGJEGJËSIMIT PËR RUAJTJEN E PYJEVE

"Dita e Dyerve të Hapura" është njëra ndër ditët më të rëndësishme dhe interesante të shkollës sonë, është dita kur ne hapim dyert për të gjithë ata që duan të shohin punën tonë. Ne mirëpresim çdo njeri, me aktivitete nga më të ndryshmet dhe ua mundësojmë atyre ta ndiejnë atmosferën e bukur në çdo cep të shkollës.

Dhe, pa dyshim, edhe ne si nxënëse të kësaj shkolle morëm pjesë në këto aktivitete, duke kryer një eksperiment hulumtues në lëndën e kimisë. Përgatitjet që ky eksperiment të shfaqej sa më mirë në "Ditën e Dyerve të Hapura" ishin të gjata dhe përplot supriza. Së bashku me mësimdhënëset tona ne punuam me orë të tëra për të arritur rezultate sa më të sakta.

Puna në laborator mund të jetë e lodhshme, mirëpo atmosfera që kishim krijuar gjatë këtyre përgatitjeve bënte që kurrë të mos e ndjenim lodhjen. Eksperimenti kërkonte shumë përgjegjësi dhe përkushtim, ngaqë një gabim i vogël gjatë procesit mund shkaktonte rezultate të gabuara, mirëpo mësimdhënëset tona ishin gjithmonë aty, që të siguroheshin se gjithçka po shkonte mirë dhe që ne të kuptonim në thelb punën që duhej të kryenim.

Eksperimenti që e zhvilluam titullohet "Matja e intensitetit të fotosintezës me metodën kimike të Winkerit", me anë të së cilës ne arritëm të përcaktojmë saktë se sa oksigjen lirohet në pyll brenda një ore. Kjo tregon për rëndësinë e madhe që kanë pyjet dhe rrit ndërgjegjësimin që të mos priten ato. Edhe pse ne çdo ditë dëgjojmë për rëndësinë e pyjeve, ta vëzhgosh vetë rëndësinë e tyre, të bën shumë më të vëtëdijshëm dhe shpresojmë se ky eksperiment ka pasur të njëjtin efekt e dhe te ata që e vëzhguan.

Gjatë "Ditës së Dyerve të Hapura" laboratori i kimisë u mbush plot me vizitorë të cilët vëzhguan me shumë vëmendje eksperimentet që kishim përgatitur. Kjo përvojë na bëri të kuptojmë se sa shumë na pëlqen puna në laborator dhe lirisht mund të themi se kjo ishte një ndër përvojat tona të veçanta dhe ndihemi me fat që patëm mundësinë të marrim pjesë në këtë aktivitet.

Ejona dhe Viola Rexhepi, kl. 12/A

## LABORARBEITEN MIT GÄSTEN

Neben vielen anderen Aktivitäten hat unsere Schule auch einen "Tag der offenen Tür", einen Tag speziell für unsere Schule.

Der Tag der offenen Tür ist ein Tag für alle, die mehr über unsere Arbeit erfahren möchten. An diesem Tag begrüßen wir Eltern, Schüler*innen, Lehrer*innen und alle Interessierten mit verschiedenen Präsentationen, um die Atmosphäre in unserer Schule zu genießen. Da ich in diesem Jahr Schülerin dieser Schule bin, habe ich mich entschieden, gleichzeitig als Assistentin in den Fächern Chemie und Biologie tätig zu sein. Die Aktivitäten zum "Tag der offenen Tür" waren nur der Abschluss, im Vorfeld wurde viel gearbeitet und geprobt, sowohl von den Lehrer*innen als auch von den Schüler*innen. Alle Experimente lieferten zufriedenstellende Ergebnisse, da unermüdlich und konzentriert gearbeitet wurde, um bestmögliche Resultate zu erzielen. Meine Arbeit als Assistentin war nicht schwierig, weil ich mit sehr fleißigen Mitschüler*innen und sehr genauen Lehrer*innen zusammengearbeitet habe.





Alles lief gut und es waren viele Gäste aller Altersgruppen im Chemielabor. Die Gäste waren sehr interessiert an allem, was im Labor passierte. Ein spontanes Experiment, das bei den Gästen sehr gut ankam, war das Verbrennen eines Magnesiumstreifens. Dies wurde jedoch nicht von den Schüler*innen unserer Schule durchgeführt, sondern von den Gästen. Es war etwas Einfaches, Spontanes und hat allen, vor allem den Jüngeren, sehr gut gefallen. Zusammenfassend möchte ich sagen, dass die Arbeit im Chemielabor immer befriedigend ist, aber diese besondere Erfahrung wird mir in Erinnerung bleiben.

Erjona Ahmeti, Klasse 11/A



## PUNË LABORATORIKE BASHKË ME MYSAFIRËT

Përveç aktiviteteve të shumta, në shkollën tonë organizohet edhe "Dita e Dyerve të Hapura" që është ditë e veçantë për të gjithë ne. Gjatë kësaj dite shkolla jonë hap dyert për të gjithë vizitorët që duan të dinë më shumë rreth punës sonë; ne mirëpresim prindërit, nxënësit dhe mësuesit me shfaqjen e aktiviteteve nga më të ndryshmet, duke ua mundësuar një ditë ku të mund ta shijojnë atmosferën në shkollën tonë.

Si nxënëse e kësaj shkolle, këtë vit përzgjedhja ime ishte që të isha asistente për aktivitetet në lëndën e kimisë e biologjisë. Aktivitetet në "Ditën e Dyerve të Hapura" ishin në fazën përfundimtare, sepse paraprakisht u bënë shumë punë dhe prova, si nga ana e profesorëve, ashtu edhe nga ana e nxënësve. Të gjitha eksperimentet dhanë rezultate të kënaqshme, pasi u bë punë e palodhshme dhe me shumë vullnet, në mënyrë që të fitonim rezultate sa më të mira.

Puna ime si asistente nuk ishte aspak e vështirë, sepse punova me nxënës shumë të zellshëm dhe profesorë shumë korrektë. Gjithçka shkoi siç duhet dhe laboratori i kimisë (vendi ku u mbajtën aktivitetet tona) u mbush me mysafirë moshash të ndryshme, të cilët shpehën interesim të madh për çdo gjë që po ndodhte në laborator. Ishte ky një aktivitet spontan, por shumë i pëlqyer nga ana e të pranishmëve, me ç'rast, djegia e shiritit të magnezit, nuk u bë nga nxënësit e shkollës sonë, por nga mysafirët.

Ishte diçka e thjeshtë, spontane e shumë e pëlqyer nga të gjithë, e, sidomos nga të vegjëlit. Në përmbyllje dua të them se puna në laboratorin e kimisë është gjithmonë e kënaqshme, përvojë kjo që do të mbetet si një nga kujtimet e mia më të mira në "Loyola-Gymnasium".

Erjona Ahmeti, kl. 11/A

## OFFENE TÜREN IN DER DEUTSCH-FACHSCHAFT

Am 29. April 2022 öffnete das "Loyola-Gymnasium" seine Türen für alle, die diesen Tag mit uns feiern wollten. Viele Gäste reisten von weit her, um mit uns diesen schönen, sonnigen Tag zu verbringen. Es fanden viele Aktivitäten in jeder Fachschaft statt. Die Fachschaft Deutsch entschied sich für eine Schreibwerkstatt.

Fiktionale Literatur wird im Unterricht, im Wesentlichen rezeptiv und analytisch durchgenommen. Der Alltagsunterricht ist aufgrund der DSD I und II-Aufgabenformate stark landeskundlich orientiert, wodurch Sachtexte überwiegen.

Den Schüler*innen soll, mittels der Arbeit an verschiedenen Textarten (literarischen Gattungen), die Literatur unter neuer Perspektive nähergebracht werden.

Dabei soll gezeigt werden, durch welche Formen die Literatur schülerzentrierter und handlungsorientierter unterrichtet werden kann und wie die interkulturelle Wahrnehmung von fiktionalen Texten gefördert werden kann.

Es sollen Produkte entstehen, wie kurze eigene literarische Texte, Comics, Zeichnungen, szenische Darstellungen, die dann den Besuchern der Veranstaltung präsentiert wurden.







## VOLUMENMESSUNG VON FESTKÖRPERN UNREGELMÄSSIGER GEOMETRISCHER FORM

Die Schüler*innen der Klasse 7A, Erda Kosova und Leart Bytyqi, waren Teil eines Experiments aus dem Fach Physik. Wie immer war es ein interessantes Experiment. Wir haben dieses Experiment mit der Hilfe von Prof. Blerton Krasniqi durchgeführt, der uns immer ermutigt, anleitet, motiviert und uns beim Lernen der Naturwissenschaften, mit besonderem Augenmerk auf die schöne Wissenschaft der Physik, leitet.

Unser Experiment lautete "Messung des Volumens von Festkörpern mit unregelmäßiger geometrischer Form".

Wir führten dieses Experiment mit drei verschiedenen Körpern durch.

Für dieses Experiment braucht man

1. Wasser
2. graduiertes Laborglas / Waage
3. Radiergummi
4. Stein

Um dieses Experiment durchzuführen, mussten wir das Glas mit Wasser ($H2O$) füllen, dann den Radiergummi in das Wasser geben, wodurch sich das Volumen von 400 ml auf 401 ml erhöhte, und schließlich den Stein in das Wasser geben, wodurch sich das Volumen von 400 ml auf 403 ml erhöhte.

Als wir das Experiment fortsetzten, fanden wir das Volumen des unregelmäßigen Körpers mit der Formel

$$V = V_2 - V_1$$

Wobei $V_1$ das Volumen des Wassers im Becher und $V_2$ das Volumen des Wassers, wenn der unregelmäßige Körper ebenfalls eingetaucht ist.

Zuerst haben wir mit dem Radiergummi begonnen und folgende Ergebnisse erhalten:

$V_1$ = 400ml $V_2$= 401ml, dann ist das Volumen für den Radiergummi:

$$V = V_2 - V_1 = 401ml - 400ml = 1ml = 1cm^3 = 0.001L$$



Für den Stein erhalten wir folgende Ergebnisse:

$V_1$ = 400ml $V_2$= 403ml, dann wird das Volumen für den Stein sein:

$$V = V_2 - V_1 = 403ml - 400ml = 3ml = 1cm^3 = 0.003L$$

Aus diesem Experiment haben wir verstanden, dass das Volumen des festen Körpers gleich der Volumenänderung nach und vor dem Einlegen des unregelmäßigen Körpers in den Wasserbehälter ist.

Erda Kosova und Leart Bytyqi, Klasse 7/A

## MATJA E VËLLIMIT TË TRUPAVE TË NGURTË ME FORMË JO TË RREGULLT GJEOMETRIKE

Ne, nxënësit e klasës 7A, Erda Kosova dhe Leart Bytyqi ishim pjesë e një eksperimenti në lëndën e fizikës. Si çdoherë, eksperimenti ishte interesant dhe e realizuam me ndihmën e prof. Blerton Krasniqi, i cili vazhdimisht, udhëzon, motivon dhe orienton në studimin e shkencave natyrore, me theks të veçantë në shkencën e fizikës.

Eksperimenti ynë ishte "Matja e vëllimit të trupave të ngurtë me formë jo të rregullt gjeometrike".

Ne e realizuam këtë eksperiment me tre trupa të ndryshëm. Për këtë eksperiment nevojiten këto mjete:

- ujë,
- gotë laboratorike e shkallëzuar,
- menzurë, gomë
- gur.

Për realizimin e këtij eksperimentit duhej ta mbushnim gotën e qelqit me ujë ($H_2O$), më pas vendosëm gomën në ujë duke e rritur vëllimin nga 400ml në 401ml dhe, në fund, e vendosëm gurin në ujë dhe nga 400ml u rrit në 403ml. Duke e vazhduar eksperimentin gjetëm vëllimin e trupit të parregullt me formulën

$$V = V_2 - V_1$$

ku $V_1$ paraqet vëllimin e ujit në gotën laboratorike, kurse

$V_2$ paraqet vëllimin e ujit kur është i zhytur edhe trupi i parregullt.

Së pari filluam për gomën dhe morëm të dhënat, pra:

$V_1$ = 400ml $V_2$= 401ml , atëherë vëllimi për gomën do të

jetë:

Për gurin, morëm të dhënat, pra:

$$V = V_2 - V_1 = 401ml - 400ml = 1ml = 1cm^3 = 0.001L$$

$V_1$ = 400ml $V_2$= 403ml, atëherë vëllimi për gurin do të jetë:

$$V = V_2 - V_1 = 403ml - 400ml = 3ml = 1cm^3 = 0.003L$$

Nga ky eksperiment ne kuptuam se, vëllimi i trupit të ngurtë është i barabartë me ndryshimin e vëllimit pas dhe para futjes së trupit të parregullt në enën me ujë.

Erda Kosova dhe Leart Bytyqi, kl. 7/A



## DAS "LOYOLA-GYMNASIUM" ORGANISIERT EINE WEITERBILDUNG IM ZENTRUM FÜR IGNATIANISCHE PÄDAGOGIK (ZIP), IN LUDWIGSHAFEN, DEUTSCHLAND



Am Morgen des 9. August 2022, nachdem wir uns von unseren Liebsten verabschiedet hatten, trafen wir uns mit unseren KollegInnen in der Schule, um zum Flughafen von Pristina zu fahren. Der Weg dorthin war nicht der Kürzeste, aber mit guter Laune kamen wir schnell an. Da es auch noch ein Feiertag war, gratulierten wir uns gegenseitig und bereiteten uns auf den Flug nach Deutschland vor. Unsere erste Station war Stuttgart. Für einige von uns war es das erste Mal, dass wir in ein Flugzeug stiegen, und das erste Mal, dass wir Deutschland besuchten.

Es war das erste Mal, dass unsere Schule diese Fortbildung organisierte. Die Gruppe bestand aus 4 KollegInnen der der Grundschule, 5 KollegInnen des Gymnasiums und 3 KollegInnen aus dem Internat. Mit diesem Austauschprojekt bewies die ALG einmal mehr, dass sie sehr daran interessiert ist, ihren SchülerInnen und PädagogInnen die besten Erfahrungen ingatianischer Erziehung und Pädagogik zu vermitteln.

Am Stuttgarter Flughafen erwartete uns der Direktor, Herr Elias Koller, der uns zum Zentrum für Ignatianische Pädagogik (ZIP) begleitete, dem ich an dieser Stelle für die Realisierung des Projektes danken möchte. Unter uns KollegInnen herrschte eine beispiellose Freude. Unsere Ankunft war ein besonderes Erlebnis, aber auch eine Herausforderung. Ich sage Herausforderung, weil es an diesem Tag einige Probleme und Verspätungen im Fahrplan der Züge in Stuttgart gab. Ich kann mit Fug und Recht sagen, dass die Hälfte unseres großzügigen Geistes, das Albanertum, seit einiger Zeit in verschiedenen Ländern Europas lebt und arbeitet, und das haben wir auch hier in Deutschland deutlich gesehen und gespürt. Nach langem Warten organisierten wir uns mit Hilfe unserer Landsleute und fuhren mit dem Auto nach Ludwigshafen. Den nächsten Tag, einen freien Sonntag, wollten wir nutzen, um die Umgebung zu erkunden. Schnell entschieden wir uns, die nahe gelegene Stadt Heidelberg zu besuchen. Beeindruckend war die große Zahl von BesucherInnen, die den Tag damit verbrachten, die Schönheiten der Stadt zu bewundern, die prächtigen alten Gebäude, das majestätische Schloss und den Fluss, der sich darunter schlängelte. All dies ließ die Stadt wie eine Märchenstadt erscheinen, was sie auch war.

Ein besonderes Erlebnis war die erste Begegnung mit Pater Tobias Zimmermann SJ und Verena Urban. Nach der Begrüßung und dem gemütlichen Zusammensitzen ging es am Sonntagabend gleich an die Arbeit. Wir hatten einen außergewöhnlichen Willen, unsere Ziele zu erreichen, und eine beispiellose Geduld, von Pater Zimmermann gelehrt zu werden. Pater Zimmermann ist Mitbegründer des Zentrums für Ignatianische Pädagogik (ZIP) und Verena Urban arbeitet dort als Beraterin für digitale Bildung.

Pater Zimmermann ist ein Mensch, der Liebe und Freude ausstrahlt. Immer lächelnd und gut gelaunt, weise und sachkundig, hat er die Sitzungen erleichtert. Er betonte immer die spirituelle Verbindung, die der Lehrer/die Lehrerin mit dem Unterrichtsmaterial herstellen muss, und dass es der Lehrer/die Lehrerin ist, der/die seinen/ihren SchülerInnen so viel Lächeln und Liebe wie möglich schenken muss, um ihnen in guten wie in schwierigen Situationen beizustehen und zu helfen.

Er trieb uns oft an und flößte der Gruppe positive Energie ein, dass wir wirklich bereit und auf dem richtigen Weg waren. Er war immer auf der Suche nach neuen Ideen. Er schätzte die unterschiedlichen Perspektiven zu bestimmten Themen, die wir diskutierten, aber er versuchte immer, uns zu einem gemeinsamen Ziel zu führen.

Ich kann ohne Zweifel sagen, dass er für jeden von uns ein inspirierendes Vorbild ist und bleiben wird - ein Synonym für den Pädagogen, aber auch für den kompetenten, weisen und sanften Führer.

Die Wochentage im Zentrum für Ignatianische Pädagogik waren mit vielen Aktivitäten ausgefüllt: Projekte und Präsentationen zu konkreten Themen, Diskussionen über

Unterrichtsfragen und -situationen, ignatianische Ansätze und neue Unterrichtsmethoden. Die KollegInnen waren voller Energie und leidenschaftlich darum bemüht, das Beste zu geben und zu bekommen. Gemeinsam fanden wir Wärme und gute Gesellschaft, Unterstützung und Arbeitswillen.

Besuch der Schule "Maria Wald".

Nach einigen Fortbildungstagen im ZIP war es am Mittwoch, den 13.07.2022 an der Zeit, Besuche außerhalb des Fortbildungszentrums zu machen. Bei diesem Besuch wurde unsere Gruppe von Verena Urban geführt. Wir besuchten die Mädchenschule "Maria Ward" in Mainz, eine Schule, die vor ca. 300 Jahren nach ihrer Gründerin benannt wurde. Die Schule befand sich in einem 500 Jahre alten Gebäude, war aber innen sehr modern und gut ausgestattet.

Auch nach so vielen Jahren hat sich die Schule die Tradition bewahrt, nur mit Mädchen und im jesuitischen Geist




zu arbeiten. 1400 Schülerinnen werden hier betreut und unterrichtet. Ziel der Schule ist es, so die Schulleiterin Frau Dr. Andrea Litzenburger, dass Frauen in allen Bereichen, insbesondere in den Naturwissenschaften, ihre Fähigkeiten unter Beweis stellen können und dass es in unserer Welt nicht Dinge nur für Frauen und andere nur für Männer gibt.

Wir waren sehr daran interessiert zu erfahren, wie die Arbeit nur mit Mädchen in der Schule funktioniert. Wie schwierig das ist, wie die Schule es geschafft hat, die Grundlagen der ignatianischen Erziehung in einer neuen Gesellschaft zu bewahren und zu stärken und weiter zu integrieren, welche zeitgemäßen Lehrmethoden sie anwenden, wie die Zusammenarbeit mit der Gemeinde ist. Fragen, auf die wir sehr wertvolle Antworten von den SchulleiterInnen erhielten, die uns sehr schnell vertrauensvoll behandelten, wofür wir ihnen auch danken.

Langsam ging unsere Fortbildungswoche zu Ende. Freitag war der letzte Tag, der auch sehr eindrucksvoll war. Für uns war extra ein Abschiedsessen organisiert worden. Wir verbrachten den Abend mit Singen und Tanzen. Am nächsten Tag verabschiedeten wir uns von der Gruppe, da die meisten von uns in den Kosovo zurückkehrten, während andere beschlossen, ihren Aufenthalt in Deutschland zu verlängern.

Alban Jahaj
Oktober 2022

## "LOYOLA-GYMNASIUM" ORGANIZON TRAJNIMIN E MËSIMDHËNËSVE NË ZIP-QENDRËN PËR PEDAGOGJI INJACIANE NË LUDWIGSHAFEN TË GJERMANISË

Mëngjesin e 9 gushtit 2022, pasi u përshëndetëm me më të dashurit tanë, së bashku me kolegët e koleget, si fillim, u takuam në shkollë, për t'u nisur më pas drejt aeroportit të Prishtinës. Rruga deri atje ishte jo fort e shkurtër, kurse ne me humor e kaluam shpejt atë. Pas përshëndetjeve dhe urimeve që bëmë, meqë ishte ditë feste, po përgatiteshim që të fluturonim për në Gjermani, më saktë ndalesa jonë e parë ishte Shtudgarti. Disa prej nesh e kishim për herë të

parë fluturimin me aeroplan, po ashtu, edhe vizitën e parë në Gjermani.

Ishte hera e parë këtë vit që shkolla jonë po realizonte dy projekte shkëmbimi me një numër kaq të madh kolegësh e kolegesh, në shkollat e qendrat e edukimit dhe arsimimit gjerman. Grupi ynë përbëhej prej gjithsej 12 anëtarësh, 4 kolegë nga "Loyola - Fillore", 5 kolegë nga "Loyola-Gymnasium" dhe 3 kolegë nga "Konvikti Loyola", kurse aktivi ynë përfaqësohej nga dy anëtarë. Me këtë projekt shkëmbimi, "Loyola-Gymnasium" dëshmoi edhe një herë se është shumë e interesuar që të sjellë për nxënësit dhe kolegët e saj përvojat më të mira të arsimimit dhe edukimit Injacian.

Në aeroportin e Shtutgartit na priti drejtori, z. Elias Koller, i cili do të na shoqëronte deri në Qendrën për Pedagogji Injaciane-ZIP dhe gjej rastin ta falënderoj për realizimin e këtij projekti. Te kolegët vërehej një gëzim i paparë. Arritja jonë ishte një emocion i veçantë, po ashtu edhe një sfidë. E them sfidë se pikërisht atë ditë kishte paksa probleme dhe vonesa në oraret e trenave në Shtutgart. Me të drejtë mund të them se një gjysmë e shpirtit tonë bujar, shqiptarizmës, tash e një kohë jeton e vepron në vende të ndryshme të Europës, atë e gjetëm këtu, në Gjermani. Pas një kohe pritjeje, u vetorganizuam falë edhe ndihmës së bashkatdhetarëve tanë  dhe se rrugën deri në Ludwigshafen e bëmë me makina. Të nesërmen, e dielë, ditë pushimi, donim ta zhfrytëzonim, të shëtisnim diku. Vendosëm shpejt që të vizitonim një qytet të afërt atje, Hajdelbergun, qytet i vjetër. Të linin përshtypje vizitorë të shumtë, të cilët arsyeshëm po e harxhonin ditën e tyre duke soditur bukuritë e qytetit, ndërtesat e vjetra e madhështore, keshtjellën hijeréndë dhe lumin që gjarpëronte nën të. Të gjitha këto i jepnin pamjen e një qyteti përrallor, çfarë vërtet ishte.

Takimi ynë i parë me Pater Tobias Zimmermann SJ si dhe Verena Urban ishte emocion i veçantë. Pasi u përshëndetëm dhe u rehatuam nëpër vendet tona, të dielën në mbrëmje, filluam menjëherë nga puna. Kishim një vullnet të jashtëzakonshëm për të treguar synimet tona, poashtu, një durim të paparë të Pater Zimmermannit për të na dëgjuar deri në fund. Pater Zimmermann ishte njëherësh themelues i Zentrum Für Ignatianische Pädagogik - ZIP, kurse Verena Urban, konsulente për edukimin digjital.

Patër Zimmermann ishte njeri që rrezatonte dashuri e gëzim të paparë. Gjithmonë i buzëqeshur dhe në humor, i urtë e i ditur, i bënte seancat më të lehta. Theksin gjithmonë e vinte te lidhja shpirtërore që mësuesi duhet ta bëjë me materien mësimore, së këndejmi, mësuesi është ai i cili duhet të shpërndajë sa më shumë buzëqeshje e dashuri për nxënësit e tij, t'u gjendet nxënësve në situata të mira dhe të vështira e t'u ndihmojë atyre.

Shpeshherë na inkurajonte dhe shtonte energji pozitive në grup, për atë se ne vërtet ishim të përgatitur dhe në rrugën e duhur. Vazhdimisht kërkonte alternativa e ide të reja. Perspektivat e ndryshme për çështje të caktuara, që i kishim kur diskutonim, i cilësonte vlera, por gjithmonë kërkonte që të arrinim më pas në një cak të përbashkët.

E them me përgjegjësi të plotë, dhe pa dyshim se për secilin prej nesh, ai është dhe do të shërbejë si model frymëzimi- sinonim i pedagogut, udhëheqësit të ditur, të urtë e të butë.

Ditët e javës në Qendrën për Pedagogji Injaciane ishin të mbushura me plot aktivitete, projekte e prezantime për tema konkrete, diskutime për çështje e situata mësimore, qasjet Injaciane, metodat e reja mësimore. Kolegët ishin tepër energjikë, të pasionuar për të dhënë dhe marrë më të mirën. Te njëri-tjetri gjetëm një ngrohtësi e shoqëri të mirë, mbështetje e vullnet për punë.

Vizita në shkollën "Maria Ward"

Pas disa ditë trajnimi në Zentrum Für Ignatianische Pädagogik - ZIP, Ludwigshafen, të mërkurën, më datë 13.07.2022, erdhi koha që të realizonim vizita jashtë qendrës trajnuese. Grupi ynë në këtë vizitë drejtohej nga Verena Urban, konsulente për edukimin digjital në ZIP dhe njëherësh trajnere jona. Ne, vizituam shkollën e femrave "Maria Ward" në Mainz të Gjermanisë, shkollë e cila e bartte emrin e themelueses së saj, diku 300 vjet më parë. Shkolla ishte vendosur në një objekt 500-vjeçar të vjetër, por që brenda ambientet ishin tejet moderne dhe të kompletuara.

Shkolla edhe pas kaq vjetësh ka ruajtur traditën e të punuarit vetëm me vajza dhe frymën e saj jezuite. Kishte 1400 nxënëse, të cilat e vijonin shkollimin e tyre këtu. Qëllimi i shkollës, sipas drejtoreshës së shkollës, znj. dr. Andrea Litzenburger, ishte që të tregojë se femrat i provojnë dhe dëshmojnë shkathtësitë e tyre në të gjitha fushat, sidomos në shkencat e natyrës, dhe se në botën tonë nuk ka gjëra vetëm për femra dhe disa të tjera vetëm për meshkuj, por gjëra që mund t'i bëjnë meshkujt, po aq mirë mund t'i

bëjnë edhe femrat.

Ne ishim shumë të interesuar të mësonim sesi funksionon puna vetëm me vajza në shkollë. Sa e vështirë është kjo, se si shkolla ka arritur që të ruajë dhe forcojë e integrojë edhe më tej bazën e edukimit Injacian në një shoqëri të re, cilat metoda të mësimdhënies bashkëkohore i përdorin, cili është bashkëpunimi i tyre me komunitetin, çështje për të cilat morëm përgjigje me shumë dashuri nga udhëheqësit e shkollës, të cilët u treguan tejet të afërt, për çka edhe i falënderojmë.

Ne hasëm në javën e projekteve në këtë shkollë. Ishte mjaft interesante se si nxënësit e punonin plastikën nga materiale që nuk ishin plastikë, me qëllim që riciklimi të bëhej shpejt, si dhe në projektet e muzikës, ku secili nxënës dhe më pas të gjithë së bashku kishin përgatitur këngë korale, përkushtuar themelueses së shkollës "Maria Ward".

Dhe, kështu, programit tonë të shkëmbimit i erdhi fundi. E premtja ishte dita e fundit, ishte mjaft mbresëlënëse. Veçmas për ne kishin organizuar një darkë ceremoniale, përshëndetëse. Atë natë e kaluam me këngë e valle. Të nesërmen u përshëndetëm me grupin, pasi shumica do të ktheheshin në Kosovë, kurse së bashku me kolegë vendosëm të qëndronim edhe për disa kohë në Gjermani.

Fat e mbarësi për secilin anëtar të grupit: Patër Zimermmann, Verenën, Shqipen- udhëheqësen e grupit, Fatmirin, Dianën, Ilirin, Arianitin, Shpëtimin, Ermirën, Blondinën, Yllzën, Valonin dhe Juditën.

Alban Jahaj,
tetor 2022



## IMPRESSIONEN VON DER FORTBILDUNG FÜR IGNATIANISCHE PÄDAGOGIK IM ZIP-ZENTRUM IN LUDWIGSHAFEN



Im Juli (2022) hatten einige Kolleg*innen des "Loyola-Gymnasiums" (aus Grundschule, Gymnasium und Internat) die Möglichkeit, an der ignatianischen Pädagogik-Ausbildung in Ludwigshafen mit den Ausbildern Tobias Zimmermann SJ und Verena Urban teilzunehmen.

Mit Hilfe des geschäftsführenden Schulleiters, Herrn Elias Koller, wurden wir in dieser kleinen Stadt untergebracht und vom ersten Tag an sehr herzlich aufgenommen. Obwohl unsere Schule auf ignatianischen Prinzipien basiert, hatten wir dort die Möglichkeit, unser Wissen zu erweitern, das, was wir im Unterricht an unserer Schule anwenden, zu bestätigen und zu ergänzen und durch die Verbindung mit den Gefühlen zu verstärken.

So wurde noch einmal betont, dass wir immer den inneren Zustand der Schüler*innen berücksichtigen und herausfinden müssen, warum es unkonzentrierte Schüler*innen gibt. Die Schüler*innen müssen lernen, wie man lernt. Sie müssen verstehen, dass wir für sie da sind, nicht nur für unsere eigene Arbeit, und dass sie einen Lehrer ihres Vertrauens haben, mit dem sie über ihre Probleme sprechen können.

Während des Trainings haben wir alle Methoden selbst in die Praxis umgesetzt und uns in verschiedene Rollen und Situationen versetzt, um so nah wie möglich zu erfahren, in welcher Situation sich die Schüler*innen befinden und wie sich diese Methoden auf sie auswirken können.

Wir besuchten auch eine Schule mit hundertjähriger Tradition in ignatianischer Pädagogik "Maria Ward" in Mainz, wo wir von den Mitarbeiter*innen begrüßt und in die Methoden, Programme und Prinzipien der Schule eingeführt wurden.

Nach unserer Rückkehr haben wir unsere Reflexionen mit allen Kolleg*innen der Schule geteilt, indem wir Präsentationen gehalten haben. Nun arbeiten wir weiter an Projekten und Kooperationen, die wir für wichtig halten.

Die Teilnehmer der Fortbildung waren Alban Jahaj, Arianit Çollaku, Blondina Ademaj, Diana Markaj, Ermira Dina, Fatmir Kastrati, Ilir Memaj, Judita Delhysa, Shpejtim Buqa, Shqipe Sharani, Valon Bajraktari und Yllza Kolloni.

Blondina Ademaj,
Prof.

## PËRSHTYPJE NGA TRAJNIMI PËR PEDAGOGJINË INJACIANE NË LUDWIGSHAFEN TË GJERMANISË, NË ZENTRUM FÜR IGNATIANISCHE PÄDAGOGIK - ZIP

Gjatë korrikut (2022), me disa kolegë të Asociation "Loyola-Gymnasium" (nga Shkolla fillore, Gjimnazi dhe Konvikti) patëm mundësinë të jemi pjesëmarrës në trajnimin për pedagogji Injaciane në Ludwigshafen të Gjermanisë, me trajnerët P. Tobias Zimmermann SJ dhe Verena Urban. Me ndihmën e drejtorit tonë ekzekutiv z. Elias Koller u akomoduam në këtë qytet të vogël, por në të cilin u mirëpritëm me shumë ngrohtësi që nga dita e parë. Edhe pse shkolla jonë mbështetet tek parimet Injaciane, atje patëm mundësinë e zgjerimit të njohurive tona, të konfirmimit e komplementimit të atyre që jemi duke i zbatuar gjatë mësimdhënies në shkollën tonë, si dhe përforcimin e tyre duke i lidhur me ushtrime të ndjenjave shpirtërore.

Pra aty u ritheksua fakti se gjithmonë duhet ta kemi parasysh gjendjen e brendshme të nxënësve e të zbulojmë pse mund të ketë nxënës të pakoncentruar. Nxënësit duhet të mësojnë se si duhet mësuar. Ata duhet ta kuptojnë se ne jemi aty për ta, e jo vetëm për një punë tonën personale dhe të kenë profesor të besueshëm të cilit mund t’i shprehin shqetësimet e tyre.

Të gjitha metodat ne i realizuam vetë në praktikë, gjatë

trajnimit, duke u futur në role e gjendje të ndryshme, për të përjetuar e prekur sa më afër ndjesinë se në çfarë situate mund të gjenden nxënësit dhe se si do të ndikojnë këto metoda tek ata.

Ne, po ashtu, vizituam një shkollë me traditë qindravjeçare të pedagogjisë injaciane "Maria Ward" në Meinz, ku u mirëpritëm nga stafi dhe u njoftuam me metodat, programet e parimet e shkollës.

Reflektimin e trajnimit e shpalosëm me të gjithë kolegët e shkollës sonë kur u kthyem, duke mbajtur prezantime dhe tani po vazhdojmë t'i zbatojmë projektet e bashkëpunimet e planifikuara, të cilave konsideruam se duhet t'u japim rëndësi të veçantë.

Pjesmarrësit në trajnim ishin Alban Jahaj, Arianit Çollaku, Blondina Ademaj, Diana Markaj, Ermira Dina, Fatmir Kastrati, Ilir Memaj, Judita Delhysa, Shpejtim Buqa, Shqipe Sharani, Valon Bajraktari dhe Yllza Kolloni.

Blondina Ademaj,
prof.



## AUSTAUSCH VON LEHRERFAHRUNGEN AN DEN UNIVERSITÄTEN HILDESHEIM UND HANNOVER



Im Juli dieses Jahres wurden sechs Lehrer*innen des "Loyola-Gymnasiums" und zwei Lehrer*innen der "Loyola-Grundschule" ausgewählt, an dem internationalen Lehrprojekt in Kooperation mit den Hochschulen "Hildesheim und Hannover" teilzunehmen. Nesrin Limani, Blerand Kolshi, Edis Galushi, Donjeta Braha, Pranvera Bytyqi, Vezire Krasniqi, Dorutina Rakaj und Katarina Gojani besuchten die oben genannten Universitäten, beobachteten Unterricht an deutschen öffentlichen und privaten Schulen und nahmen an organisierten Workshops über kooperatives Lernen und effektives Klassenmanagement teil.

Bei den Unterrichtsbeobachtungen fiel auf, dass im deutschen Bildungssystem besonderer Wert auf die Lernumgebung, moderne Unterrichtsmaterialien, das ungestörte Arbeiten der Schüler*innen während des Unterrichts, die Unterstützung durch die Verantwortlichen sowie die Einbeziehung der Schüler*innen bei der selbstständigen Arbeit nach Anleitung in verschiedenen Aktivitäten gelegt wird. Währenddessen konzentrierte sich der Workshop über kooperatives Lernen auf Gruppenarbeit, Eigenverantwortung, Reflexion über den Fortschritt des Arbeitsprozesses und verschiedene Kooperations-, Organisations- und Führungskompetenzen für eine effektivere Zusammenarbeit. Andererseits wurde im Workshop über erfolgreiches Klassenmanagement die Bedeutung von Motivation und Konzentration der Schüler*innen beim aktiven Lernen und die Gestaltung eines Unterrichts mit minimalen Unterbrechungen diskutiert.

Dieses Programm bot uns die einzigartige Gelegenheit, neue pädagogische Ideen zu entwickeln, unsere Fähigkeiten als Lehrer*innen zu verbessern, internationale Perspektiven in unsere Klassenzimmer einzubringen und wert-

volles Wissen zu erwerben, indem wir uns verschiedenen Bildungssystemen und Bewertungsmethoden ausgesetzt sahen. Der Ideen- und Wissensaustausch mit anderen Lehrer*innen auf diesem Gebiet hat uns geholfen, neue Verbindungen zu knüpfen und unser professionelles Netzwerk zu erweitern. Darüber hinaus hat diese einzigartige Gelegenheit unsere kulturelle Intelligenz und unsere globalen Kompetenzen gefördert, was sich direkt auf unsere Lehrfähigkeiten auswirken wird, insbesondere auf unsere Fähigkeit, immer vielfältigere Schülergruppen zu unterrichten. Gleichzeitig profitieren unsere Schüler*innen und Kolleg*innen von unserem erweiterten kulturellen Weltbild.

Neben den wunderbaren Erfahrungen und dem Gedanken- und Erfahrungsaustausch hatten unsere deutschen Partner*innen in diesem Projekt auch informative Besuche der wichtigsten Kunst- und Kulturzentren in Hildesheim und Hannover organisiert. Die Erfahrung dieses Austausches wird für alle, die daran teilgenommen haben, unvergesslich bleiben. Darüber hinaus wird die Diskussion und Umsetzung dieser Erfahrungen in unserer Schule allen in der ALG zugute kommen.

Donjeta Braha,
Englisch-Lehrerin
Edis Galushi,
Englisch-Lehrer

## SHKËMBIMI I PËRVOJAVE TË MËSIMDHËNIES NË UNIVERSITETIN E HILDESHEIM-IT DHE HANNOVER-IT



Në korrik të këtij viti, gjashtë profesorë nga Gjimnazi "Loyola" dhe dy mësuese nga "Loyola Fillore" u përzgjodhën për të marrë pjesë në projektin ndërkombëtar të mësimdhënies në bashkëpunim me Universitetin e "Hildesheim-it dhe Hannover-it". Nesrin Limani, Blerand Kolshi, Edis Galushi, Donjeta Braha, Pranvera Bytyqi, Vezire Krasniqi, Dorutina Rakaj dhe Katarina Gojani vizituan universitetet e lartpërmendura, vëzhguan orë mësimore në shkolla publike dhe private gjermane si dhe morën pjesë në punëtoritë e organizuara për të mësuarit bashkëpunues dhe menaxhimin efektiv të klasës.



Në orët e vëzhguara mësimore është vënë re që sistemi eduaktivo-arsimor gjerman i kushton rëndësi të veçantë ambientit mësimor, materialit mësimor modern, punës së nxënësve pa presion gjatë orës mësimore, përkrahjes nga personat përgjegjës si dhe gjithëpërfshirjes së nxënësve, e ndërlidhur kjo me punë të pavarur sipas udhëzimeve në aktivitete e veprimtari të ndryshme. Ndërkaq, në punëtorinë mbi të mësuarit bashkëpunues u diskutua për punën në grupe, përgjegjësinë individuale, reflektimin ndaj mbarëvajtjes së procesit të punës dhe shkathësitë e ndryshme të bashkëpunimit, organizimit dhe udhëheqjes për një bashkëpunim sa më efikas. Në anën tjetër, në punëtorinë rreth menaxhimit të suksesshëm të klasës u diskutua për rëndësinë e motivimit dhe përqëndrimit të nxënësve në mësimin aktiv dhe organizimin e një ore mësimore me minimum të ndërprerjeve.

Ky program na ofroi mundësinë unike për të zhvilluar ide të reja pedagogjike, për të përmirësuar aftësitë tona si mësimdhënës, për të sjellë perspektiva ndërkombëtare në klasat tona dhe për të fituar njohuri të vlefshme, duke u ekspozuar ndaj sistemeve të ndryshme arsimore dhe metodave të vlerësimit. Shkëmbimi i ideve dhe njohurive me profesorë të tjerë të fushës, na ka ndihmuar të krijojmë lidhje të reja dhe të rrisim rrjetin profesional. Përveç kësaj, kjo mundësi e artë na ka zhvillluar inteligjencën kulturore dhe kompetencat globale, të cilat do të avancojnë drejtpërdrejt aftësitë tona të mësimdhënies, veçanërisht aftësinë dhe kapacitetin për të mësuar grupe studentore gjithnjë e më të ndryshme. Njëkohësisht, studentët dhe kolegët tanë do të përfitojnë nga botëkuptimi ynë i zgjeruar kulturor.

Krahas përvojës së mrekullueshme dhe shkëmbimit të ideve e përvojave, partnerët tanë gjerman në këtë projekt kishin organizuar edhe vizita informative në qendrat kryesore të artit dhe kulturës në Hildesheim dhe Hannover. Përvoja nga kjo mundësi shkëmbimi do të mbetet e paharrueshme për të gjithë ne që ishim pjesë e saj. Për më tepër, nga diskutimi dhe aplikimi i kësaj përvoje në shkollën tonë do të përfitojnë të gjithë ata që janë pjesë e Asociation "Loyola-Gymnasium".

Donjeta Braha, prof. dhe
Edis Galushi, prof.



## AUSTAUSCH MIT DER UNIVERSITÄT HILDESHEIM UND HANNOVER

Am Ende des Schuljahres 2021/22 verbrachte eine Gruppe von acht Lehrern des "Loyola-Gymnasiums", darunter zwei Lehrer der Fachschaft Deutsch - Frau Nesrin Limani und Frau Vezire Krasniqi - eine Woche in Hildesheim und Hannover im Rahmen eines Austauschprogramms mit der Universität Hildesheim / Hannover. Die Partnerschaft zwischen der ALG und der Universität Hildesheim / Hannover wurde im September letzten Jahres beim Besuch der ersten Delegation dieser Universitäten in Prizren geschlossen.

Die erste Austauschgruppe von ALG-Lehrkräften hatte die Gelegenheit, an verschiedenen Workshops teilzunehmen und Vorträge von verschiedenen Professor*innen aus dem Bereich Lehramt an diesen Universitäten zu hören. Die Vorträge und Workshops befassten sich mit aktuellen Themen der Unterrichtsentwicklung und modernen Unterrichtsmethoden im Allgemeinen. Einige der behandelten Themen waren z.B. "Classroom Management", "Cooperative Learning and Feedback", etc.

Sie besuchten auch den Fachbereich Germanistik und Deutsch als Fremdsprache (DaF) der Universität Hildesheim und wurden dort über aktuelle Projekte informiert, wie z.B. TRANSLANG (translanguaging), das sich mit Mehrsprachigkeit und der Verwendung mehrerer Sprachen im Unterricht beschäftigt. Neben den Aktivitäten an den Universitäten Hildesheim und Hannover nahmen sie auch an Hospitationen teil. Sie besuchten die Grundschule "Alter Markt" und das Gymnasium "Andreanum" in Hildesheim und konnten dort in verschiedenen Fächern hospitieren. Außerdem wurden erste Kontakte zu diesen Schulen geknüpft, deren Vertreter Interesse an einer zukünftigen Partnerschaft mit dem ALG bekundeten.

Die Koordinatorin des Austausches, Frau Annette Lützel, hatte ein abwechslungsreiches Programm zusammengestellt, das neben den Aktivitäten an den Universitäten und Schulen auch einige interkulturelle Elemente enthielt. Die Lehrkräfte hatten die Gelegenheit, wichtige Sehenswürdigkeiten zu besichtigen und die Geschichte von Hildesheim und Hannover sowie die deutsche Kultur im Allgemeinen kennen zu lernen.

Am letzten Tag des Besuchs trafen sich die ALG-Lehrer mit einer Gruppe von Studierenden im letzten Studienjahr der Pädagogischen Fakultät der Universität Hildesheim zu einer Austauschveranstaltung. Diese Gruppe von 16 Studierenden hielt sich dann im August und September im Kosovo auf und absolvierte ein Unterrichtspraktikum an der "Loyola Fillore" und am "Loyola-Gymnasium" in Prizren. Während dieser Veranstaltung wurden Arbeitsgruppen bzw. Tandemgruppen für verschiedene Unterrichtsfächer gebildet und der Hospitationsplan besprochen, der im September in Prizren durchgeführt werden sollte. Es wurden auch erste Ideen vorgestellt, wie diese Studierenden ihren Unterricht in Prizren planen werden. Seitens der Studierenden wurden Fragen zum Unterrichtsablauf an unserer Schule gestellt. Anschließend fand ein gemeinsames Abendessen statt.

Dieser Austausch war sehr produktiv für die zukünftige Zusammenarbeit mit den Universitäten Hildesheim und Hannover. Neben dem sehr herzlichen Empfang durch den Prorektor, Herrn Prof. Dr. Jürgen Sander, und alle am Austauschprogramm beteiligten Mitarbeitern, hatte die Gruppe der ALG-Lehrer die Möglichkeit, die Fachbereiche dieser Universitäten näher kennenzulernen und einen Einblick in die neuesten und erfolgreichsten Lehrmethoden zu erhalten. Darüber hinaus hatten sie die Möglichkeit, neue Kontakte für mögliche zukünftige Partnerschaften und Kooperationen zu knüpfen, die der gegenseitigen Verbreitung des Wissenshorizonts im Bereich des modernen Unterrichts und der interkulturellen Kommunikation dienen werden.

Nesrin Limani, prof,
Vezire Krasniqi, prof.



## SHKËMBIMI ME UNIVERSITETET E HILDESHEIM DHE HANNOVER

Me përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 një grup prej tetë mësimdhënësish të ALG-së prej datës 03.07.2022 deri më datën 09.07.2022 qëndruan në qytetet Hildesheim dhe Hannover të Gjermanisë në kuadër të bashkëpunimit me Universitetet e Hildesheim dhe Hannover, gurthemeli i të cilit u vë në shtator të vitit të kaluar gjatë vizitës së delegacionit të këtyre universiteteve në ALG në Prizren. Nga aktivi i gjuhës gjermane në këtë shkëmbim morën pjesë profesoresha Nesrin Limani dhe profesoresha Vezire Krasniqi.

Ky grup i mësimdhënësve të ALG-së, si grupi i parë në kuadër të këtij shkëmbimi, kishte rastin që të merrte pjesë në workshop-ë të ndryshëm si dhe të ndiqte ligjërata nga profesorë të mirënjohur nga fusha e edukimit pranë këtyre universiteteve. Ligjëratat trajtonin tema aktuale sa i përket mësimdhënies dhe metodave bashkëkohore në përgjithësi, siç ishin "Classroom Management", "Cooperative Learning and Feedback" etj. si dhe në Departamentin e Gjuhës Gjermane dhe Gjuhës Gjermane si Gjuhë e Huaj pranë Universitetit të Hildesheim janë njoftuar me projektet aktuale si TRANSLANG (translanguaging) që trajtonte temën e shumëgjuhësisë dhe përdorimit të shumë gjuhëve gjatë procesit mësimor në klasa.

Përveç aktiviteteve në hapësirat e Universitetit të Hildesheim dhe Universitetit të Hannover ata morën pjesë edhe në hospitime në orët mësimore të lëndëve të ndryshme në Shkollën Fillore "Alter Markt" dhe në Gjimnazin "Andreanum" në qytetin e Hildesheim. Me këtë rast u vunë edhe kontaktet e para me këto shkolla, të cilat shprehën interesimin e tyre për krijimin e partneriteteve me ALG-në në të ardhmen.

Koordinatorja e këtij shkëmbimi, zonja Annette Lützel, kishte përgatitur një program të larmishëm, i cili përveç aktiviteteve nëpër universitete dhe shkolla, përfshinte edhe aktivitete ndërkulturore. Mësimdhënësit patën rastin që t'i vizitonin monumentet me rëndësi të veçantë dhe të njihen më nga afër me historinë e Hildesheim dhe Hannover si dhe me kulturën gjermane në përgjithësi.

Në ditën e fundit të vizitës grupi i mësimdhënësve të ALG-së në një seancë shkëmbimore u takua edhe me grupin e studentëve të vitit të fundit të studimeve pranë Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Hildesheim. Ky grup prej 16 studentësh pastaj qëndruan në Kosovë në muajin gusht dhe shtator dhe kryen praktikën e mësimdhënies në "Loyola Fillore" dhe "Loyola Gymnasium" në Prizren. Gjatë kësaj seance u krijuan grupe punuese në grupe-tandem për lëndë të ndryshme dhe u diskutua plani i hospitimeve, që pritej të realizohej në shtator në Prizren. Gjithashtu u prezantuan edhe idetë e para të tyre, se si planifikojnë një orë mësimore dhe studentët shtruan pyetje në lidhje me procesin mësimor në shkollën tonë. Takimi u përmbyll me një darkë të përbashkët.

Ky shkëmbim ishte shumë i frytshëm në aspektin e bashkëpunimit me Universitetet e Hildesheim dhe Hannover në të ardhmen. Grupi i mësimdhënësve të ALG-së, përveç mikpritjes jashtëzakonisht të ngrohtë nga ana e prorektorit, prof. dr. Jürgen Sander, dhe gjithë personelit, patën mundësinë që të njihen më nga afër edhe me fushat studimore në këto universitete, me metodat bashkëkohore të mësimdhënies të dëshmuara si shumë të suksesshme, si dhe të krijojnë kontakte për partneritete dhe bashkëpunime të reja, të cilat në mënyrë të ndërsjellë do ta zgjerojnë horizontin e njohurive nga fusha e mësimdhënies moderne dhe e komunikimit ndërkulturor.

Nesrin Limani, prof,
Vezire Krasniqi, prof.



## DIE FACHSCHAFT DEUTSCH



Nach langer Zeit ist es wieder soweit, dass unser Jahrbuch wieder gedruckt wird und es freut mich sehr über unsere Fachschaft etwas verfassen zu können/dürfen.

In dieser Zeit ist natürlich vieles passiert, jedoch werde ich versuchen die wichtigsten Geschehnisse in diesem Artikel zusammenzufassen.

Ich heiße Shpres Zeka Karanezi und bin Leiterin der Fachschaft Deutsch. Seit neun Jahren bin ich am "Loyola-Gymnasium" als Deutschlehrerin tätig und bin ich in dieser Zeit über mich hinausgewachsen. Unten im Bild sehen sie unsere Lehrer*innen der Fachschaft Deutsch.

Shpres Zeka Karanezi,

Leiterin Fachschaft Deutsch

## GRUNDLAGEN DER UNTERRICHTSENTWICKLUNG

Was in dieser Zeit unsere Fachschaft sehr bereichert hat, ist der von Pasch und der ZfA angebotene DSD GOLD Kurs "Grundlagen der Unterrichtsentwicklung". Der Kurs hatte als Ziel die Entwicklung und Durchführung eines kompetenzorientierten Unterrichts und die Vertiefung methodisch-didaktischer Methoden.

Teilnehmer*innen des Kurses waren nicht nur wir Loyola Lehrer*innen, sondern auch Kolleg*innen aus DSD und Pasch Schulen in Albanien. Der Kurs hat neun Monate gedauert und beinhaltete außer Onlinephasen auch zwei Präsenzseminare. Das erste Präsenzseminar fand im Febru-





ar 2021 vor Ort an unsere Schule statt und das Zweit im Juni 2021 in Shkodra, wo auch der letzte Seminarteil abgeschlossen wurde und wir die Zertifikate bekamen.

## DSD II – GOLD KURS

Auch für das DSD II bot die ZfA und Pasch wieder einen GOLD Kurs an.

Ziel des DSD II GOLD Kurses ist es, uns (und somit auch unsere Schüler*innen) auf die Hinführung zum DSD II optimal vorzubereiten. Dabei geht es auch um die Vertiefung bzw. Auffrischung unserer methodisch-didaktischen Kompetenzen als Lehrkraft im DSD-Programm.

Dieses Mal war der Kurs noch bunter, da neben uns ALG "Loyola" Lehrer*innen auch Lehrer*innen aus Albanien und Nord Mazedonien teilnahmen. Insgesamt haben 23 Lehrer*innen aus drei Ländern Teilgenommen. Der Kurs bestand wieder aus zwei Präsenzseminaren, eines in Prizren und eines in Ohrid. Nach Monaten der Arbeit wurden wir als DSD II Prüfer*innen zertifiziert.



## NOTWENDIGKEIT, BEDEUTUNG UND NUTZEN VON HAUSAUFGABEN FÜR SCHÜLERINNEN UND SCHÜLER

"Die Pflege eines gesunden und fleißigen Geistes ist das größte Verdienst, für das jede*r Lehrer*in arbeitet", und genau daraus entstand die Idee für das Projekt "Hilfe bei den Hausaufgaben". Das Projekt hat sich insgesamt gut entwickelt. Es wurde sechs Wochen in Folge in der Bibliothek des "Loyola-Gymnasiums" durchgeführt und konnte die Meinung der Schüler*innen der 6. und 8. Klasse darüber einholen, wie sehr ihnen Hausaufgaben dabei helfen, sich die im Unterricht behandelten Inhalte anzueignen.

Zunächst wurde mit kleinen Gruppen von Schüler*innen gearbeitet, wie z.B. den Klassensprechern und Vertretern von Gruppen, die regelmäßig ihre Hausaufgaben machen und denen, die unregelmäßig Hausaufgaben machen. In der letzten Woche haben die Schüler*innen in jeder der oben genannten Parallelklassen an ihren eigenen Projekten gearbeitet, in denen alle in der Klasse über die Notwendigkeit, die Wichtigkeit und den Nutzen von Hausaufgaben nachgedacht haben.

Hausaufgaben sind generell eine Hilfe bei der Aneignung von Inhalten, da sie helfen, das im Unterricht erworbene Wissen aufzufrischen und im Gedächtnis zu verankern. Durch die regelmäßige Bearbeitung der Aufgaben verringert sich auch der Zeitaufwand für die Wiederholung des Gelernten zu Hause. Außerdem fühlen sich die Schüler*innen besser vorbereitet, wenn sie sich einem kleinen Überraschungstest oder sogar einer Klassenarbeit unterziehen müssen. Besonders wichtig ist es jedoch, die Schüler*innen für den Nutzen von Hausaufgaben zu sensibilisieren, damit sie ihre Hausaufgaben selbstständig erledigen und nicht von Freunden abschreiben, "nur um sich die Sorgen zu nehmen", denn auf diese Weise wird der mit den Hausaufgaben beabsichtigte Effekt nicht erreicht. Natürlich ist auch die Menge an Hausaufgaben eine Herausforderung für die Lerner*innen. Wenn sie von jedem Fach aufgegeben werden, haben die Schüler*innen ein Problem mit der Einteilung ihrer Freizeit, die sie neben dem Wiederholen auch für andere produktive Aktivitäten nutzen, wie z.B. sportliche Aktivitäten, Musikschule, verschiedene Kurse, etc.

Basierend auf dieser Arbeitsgruppe und den Reflexionen, die wir von den Schüler*innen erhalten haben, wurde es als notwendig erachtet, dass die Lehrer*innen vielfältigere Hausaufgaben einbeziehen. Hausaufgaben, die ein Engagement in Paaren oder Gruppen erfordern, sowie Hausaufgaben, die den Schüler*innen mehr Möglichkeiten zur Recherche und zur Entwicklung kritischen Denkens bieten, können Indikatoren für bessere Ergebnisse im Lernprozess sowie im Sozialisierungsprozess sein.

Das Projekt wurde von den Lehrerinnen Majlinda Haxhaj, Ermira Mazreku, Nesrin Limani und Nora Hoxha organisiert.



## NEVOJA, RËNDËSIA DHE DOBIA E DETYRAVE TË SHTËPISË PËR NXËNËSIT

"Kultivimi i mendjes së shëndoshë dhe punëtore është merita më e madhe për të cilën punon secili mësimdhënës" dhe pikërisht nga këtu buroi ideja në lidhje me projektin "Merrni ndihmë me detyrat e shtëpisë". Projekti në përgjithësi ka pasur një ecuri të mbarë. Është realizuar në bibliotekën e "Loyola-Gymnasium" për gjashtë javë me radhë dhe është arritur që të merret mendimi i nxënësve të klasave të 6-ta e 8-ta në lidhje me atë se sa u ndihmojnë atyre detyrat e shtëpisë në përvetësimin e përmbajtjeve të përpunuara në klasë. Fillimisht është punuar me grupe të


KADARE

vogla nxënësish, si përfaqësues të klasave dhe përfaqësues të grupeve të nxënësve të rregullt në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe me ata të parregullt në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Javën e fundit në secilën nga klasat e paraleleve të lartpërmendura nxënësit kanë punuar vetë projekte, ku të gjithë në klasë kanë reflektuar në lidhje me nevojën, rëndësinë dhe dobinë e detyrave të shtëpisë.

Detyrat në përgjithësi mbeten një ndihmesë në përvetësimin e përmbajtjeve, sepse ndihmojnë në rifreskimin e njohurive të fituara në klasë dhe në ngulitjen e tyre në kujtesë. Me kryerjen e rregullt të detyrave reduktohet edhe koha e nevojshme për përsëritjen e mësimeve në shtëpi. Po ashtu, nxënësit e ndiejnë veten më të përgatitur, nëse duhet t'i nënshtrohen ndonjë testi të vogël të befasishëm apo edhe ndonjë testi të madh. Mirëpo rëndësi të veçantë përbën ngritja e vetëdijes së vetë nxënësve në lidhje me dobinë që sjellin detyrat e shtëpisë, në mënyrë që ata, detyrat t'i bëjnë vetë, në mënyrë të pavarur e të mos i kopjojnë ato nga shokët apo shoqet, të mos i bëjnë ato "sa për ta hequr brengën", sepse në këtë mënyrë nuk arrihet efekti i synuar, përmes bërjes së detyrave të shtëpisë. Sigurisht edhe sasia e detyrave të shtëpisë përbën një sfidë për nxënësit. Nëse ato jepen nga secila lëndë, atëherë nxënësit kanë problem me menaxhimin e kohës së tyre të lirë, të cilën, përveç përsëritjes, e shfytëzojnë edhe për aktivitete të tjera produktive, siç janë p.sh. aktivitetet sportive, shkolla e muzikës, kurset e ndryshme etj.

Bazuar në këtë punëtori dhe reflektimet që kemi marrë nga nxënësit, u pa e nevojshme që të përfshihen llojllojshmëri detyrash nga mësimdhënësit. Detyrat që kërkojnë angazhim në çift apo në grup, si dhe detyrat  që u japin atyre më shumë mundësi për hulumtim dhe zhvillim të mendimit kritik, mund të jenë tregues të një rezulati më të kënaqshëm në procesin e të nxënit, po ashtu edhe në procesin e socializimit. Ky projekt u organizua nga mësimdhënëset Majlinda Haxhaj, Ermira Mazreku, Nesrin Limani dhe Nora Hoxha.

M. Haxhaj,
E. Mazreku,
N. Limani dhe
N. Hoxha

## MATHEMATIK-QUIZ

Am 28.06.2022 fand unter den Schüler*innen der achten Klasse das "Mathematik-Quiz" mit Kooperations- und "Wettkampf"-Charakter statt.

Die Fragen wurden aus den Unterrichtseinheiten der 8. Klasse ausgewählt und dienten den teilnehmenden Schüler*innen dazu, logisch und kritisch über die Lösung von Problemen im Bereich der Mathematik und anderer Fächer nachzudenken. Dadurch wurde den Schüler*innen die Möglichkeit gegeben, die notwendigen mathematischen Kenntnisse und Ausdrücke und deren Anwendung im Alltag zu üben!

Das Quiz wurde von den 8-d-Klässler*innen Rozë Hoti und Era Kuqi geleitet. Die teilnehmenden Schüler*innen traten in zwei Gruppen A und B aufgeteilt an. Am Ende des Quiz wurde die Gewinnergruppe bekannt gegeben. Der Grund für die Organisation des Quiz war, dass sich die Schüler*innen neben dem Wissenserwerb auch unterstützt und motiviert fühlten. Während der Zeit arbeiteten die Schüler*innen zusammen und reflektierten ihren positiven Eindruck.

Die Lehrer*innen Erëblina Dogani und Dredëza Qafëleshi organisierten das Projekt.

Wir hoffen, dass ähnliche Aktivitäten in Zukunft auch mit größeren Gruppen durchgeführt werden!

Dredëza Qafëleshi, Prof.,
Erëblina Dogani, Prof.



## SFIDA MATEMATIKORE

Më 28.06.2022 u mabajt "Kuizi sfidues matematikor" me karakter garues e bashkëpunimi në mes nxënësve të klasës së tetë.

Pyetjet ishin të përzgjedhura nga njësitë mësimore të klasës së tetë, ndërsa qëllimi i kuizit ishte nxitja e të menduarit logjik e kritik në zgjidhjen e problemeve brenda fushës së matematikës dhe fushave të tjera. Përmes kuizit nxënësit kishin rast t´i praktikonin njohuritë dhe shprehjet matematikore të nevojshme dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme.

Kuizi u udhëhoq nga nxënëset e klasës 8/D Rozë Hoti dhe Era Kuqi, ndërsa nxënësit pjesëmarrës garuan të ndarë në dy grupe dhe, pas përfundimit, u shpall edhe grupi fitues. Arsyeja e organizimit të kuizit me karakter garues ishte që, përveç njohurive, nxënësit të ndjehen të mbështetur dhe të motivuar. Përgjatë kohës së kuizit nxënësit bashkëpunuan dhe reflektuan pozitivitet.

Mësimdhënëset organizatore të projektit ishin Erëblina Dogani dhe Dredhëza Qafëleshi. Shpresojmë që aktivitete të ngjashjme do të mbahen edhe me grupe më të mëdha.

Dredëza Qafëleshi, prof.,
Erëblina Dogani, prof.






## "KOSOVO 3 MINUTEN"

Ein kleines und junges Land wie das Kosovo vermittelt selten den Eindruck, dass es über besondere Naturschönheiten und kulturelle Vielfalt verfügt. Es sind nicht nur die Naturschönheiten, sondern auch die vielen historischen Denkmäler, die den neuen Staat Kosovo in den Augen der Welt nicht so neu erscheinen lassen. Obwohl es reich genug ist, um ein touristisches Zentrum auf der Balkanhalbinsel zu sein, ist es noch nicht dort, wo es sein sollte.

Aus diesem Grund entstand die Idee des Kanals "Kosova 3 Minuten". Die Schüler*innen unserer 11. Klasse des Gymnasiums wollten durch die Kombination von Natur- und Kulturgütern, die wir als Volk besitzen, in Bezug zur Technik, den Kosovo im Jahr 2021 in einer anderen Dimension zeigen, näher an der Welt. Wenn man bedenkt, dass die Technologie für jeden von uns zum Alltag geworden ist - warum sollte man sie dann nicht auf die effektivste Art und Weise nutzen, die sich positiv auf unser Land auswirkt? Die Informationsvideos auf dem Kanal "Kosova 3 Minuten" sind kurze Informationsvideos, die ausschließlich von Schüler*innen des "Loyola Gymnasiums" erstellt wurden. Nach Fertigstellung und Auswahl werden die besten Arbeiten auf dem Kanal veröffentlicht. Inzwischen ist dies zu einer Art Tradition für jeden Jahrgang der 11. Klasse geworden, als eines der besonderen Projekte während der dreijährigen Gymnasialzeit.




In diesem Jahr hatten wir als Schüler*innen des Gymnasiums die Gelegenheit, an diesem Projekt mitzuwirken. Zuerst schien es eine Herausforderung zu sein, denn einen Film zu drehen, egal wie kurz er ist, erfordert Anstrengung und Hingabe. Die Idee, einen Film an einem Ort wie der Festung "Maja e Shkodran" zu drehen, entstand, weil es sich um einen ganz besonderen Ort mit einer beeindruckenden Geschichte handelt, der aber den Menschen überhaupt nicht bekannt ist.

Durch die Produktion des Films haben wir nicht nur mehr über die Geschichte der Stadt Rahovec erfahren, sondern auch unser Ziel erreicht, sie mit anderen zu teilen. Obwohl wir während der Produktion auf viele Schwierigkeiten gestoßen sind, hat uns unser Durchhaltevermögen motiviert, weiterzumachen und unser Bestes zu geben. Trotz der anstrengenden Arbeit hat uns die Arbeit an diesem Projekt sehr viel Spaß gemacht.

Der ganze Sinn des Projekts ist, dass wir zufrieden und stolz auf unsere Arbeit an dem Film sind, der komplett unsere eigene Kreation ist. Durch diesen Film haben wir die Möglichkeit, unsere Kreativität beim Filmen, Schneiden, bei der Musikauswahl und bei der Vermittlung von Informationen den Zuschauern zu zeigen und sie über die verschiedenen touristischen Attraktionen unseres Staates Kosovo zu informieren.

Es gibt keine Kriterien oder Bedingungen, die erfüllt werden müssen, um einen Beitrag über das Land zu erstellen. Es genügt die Absicht und der Wunsch, dass wir heute oder morgen das Land lieben und unser Bestes geben, um es zu fördern. Wenn gestern der Kampf um die Freiheit eine Bedingung für das Land war, und dann ein Hindernis für die Entwicklung des Bildungsgeistes, so ist es heute die Technologie, die am besten zu seiner Förderung beitragen kann.

Dieser Kanal wurde mit Hilfe des Loyola-Gymnasiums realisiert, dem wir diesen Erfolg zu verdanken haben, und

wir möchten insbesondere dem Lehrer für Technologie, Blerand Koshi, für seine unermüdliche Arbeit und für die Gelegenheit danken, unsere Arbeit in ihrer besten Form präsentieren zu können.

Anita Rexhepi, Klasse 12/C,
Sara Poniku, Klasse 12/C

## "KOSOVA 3 MINUTA"

Një shtet i vogël dhe i ri si Kosova vështirë se lë përshtypjen që ka një bukuri të veçantë natyrore dhe një diversitet kulturor. Jo vetëm bukuritë natyrore, por edhe monumentet e shumta historike e bëjnë shtetin e ri të Kosovës jo aq të ri në sytë e botës. Edhe pse mjaft i pasur për të qenë një qendër turistike në Gadishullin Ballkanik, ky sektor nuk është fare në pikën në të cilën duhet të jetë.

Andaj lindi ideja për kanalin "Kosova 3 minuta" ku ishin vetë nxënësit e "Loyola-Gymnasium" të klasave të 11-ta, në vitin 2021, ku, përmes kombinimit të pasurive natyrore e kulturore që vetë ne si popull i posedojmë, në raport me teknologjinë e cila është vetë thelbi i jetës dhe përditshmërisë së sotme ta shfaqim Kosovën në një dimension tjetër, më afër botës. Duke e parë se teknologjia sot është bërë e pashmangshme për secilin prej nesh, pse të mos e përdorim atë në formën më efektive, për të ndikuar pozitivisht për shtetin tonë. Videot informuese në kanalin "Kosova 3 minuta" janë të shkurta e informuese, tërësisht produkt i nxënësve të shkollës sonë, ku pas përfundimit dhe përzgjedhjes së tyre, punimet më të mira publikohen në kanal. Sot kjo ka kaluar në një lloj tradite për çdo vit të klasave të 11-ta, si një nga projektet më të veçanta gjatë tre vjetëve të shkollimit në "Loyola-Gymnasium".

Duke qenë nxënëse të këtij gjimnazi, këtë vit patëm mundësinë e pjesëmarrjes në këtë projekt. Në fillim tingëlloi një sfidë, pasi që realizimi i një filmi, sado i shkurtër të jetë, kërkon mund dhe përkushtim. Ideja për krijimin e një filmi në një vend si kalaja "Maja e Shkodranit" erdhi pasi



është një vend mjaft i veçantë, me një histori mbresëlënëse, por aspak i njohur për publikun e gjerë. Me realizimin e filmit, përveç se mësuam më tepër për historinë e qytetit të Rahovecit, gjithashtu ia arritëm qëllimit ta ndajmë atë me të tjerët. Edhe pse gjatë editimit hasëm në shumë vështirësi, ishte këmbëngulja jonë ajo e cila na motivoi të vazhdonim tutje dhe të jepnim më të mirën. Pa marrë parasysh punën e lodhshme, nuk mund ta lëmë anash faktin se mundësia e bashkëpunimit në këtë projekt bëri që të argëtoheshim pa masë.

I tërë qëllimi i projektit ishte që ne të jemi të kënaqur dhe krenarë me punën të cilën e ofrojmë në film, i cili është plotësisht i krijuar nga vetë ne. Përmes këtij filmi na jepet mundësia e shfaqjes së kreativitetit tone, si në xhirime, në editim, në përzgjedhjen e muzikës dhe bartjen e informacioneve te shikuesit, duke i njoftuar me pikat e ndryshme turistike të cilat i posedon shteti ynë, Kosova. Andaj që të kontribuosh për shtetin tënd nuk kërkohet asnjë lloj kriteri e asnjë lloj kushtëzimi. Mjafton qëllimi dhe dëshira që ta duam vendin dhe të japim më të mirën për promovimin e tij. Nëse dje, për vendin ishte kusht lufta për lirinë e saj, e më pas, pena për zhvillimin e frymës edukative, sot është teknologjia ajo përmes së cilës më së miri mund të ndihmojë në promovimin e saj në formën dhe me frymën që i takon. Ky kanal u realizua falë ndihmës së "Loyola-Gymnasium" që i atribuohet ky sukses, ndërsa, veçanërisht duam ta falënderojmë profesorin e TIK-ut, Blerand Koshin, për punën e palodhshme dhe për mundësinë e dhënë që të shfaqim punën tonë në formën më të mirë. Që t'i shikoni nga afër dhe të jeni të informuar në çdo hap me videot tona, ju rekomandojmë që ta vizitoni kanalin tonë "Kosova 3 minuta" në Youtube dhe të bëni Subscribe.

